

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

024

PETRIKA DRAGOTI

THYERJA E QIVURIT

TREGIME

854-32

0 24.

PETRIKA DRAGOTI

THYERJA E QIVURIT

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 6.000 kopje

Formati 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re.

Tiranë, 1976

MES DITËVE

Flokët llapavecë të borës, në fluturimin e tyre, u bënë më të dendur. Napa e bardhë veshi çdo gjë përreth: qiellin, lulishten përfund ambulancës, parvazin e dritares në dhomën e vizitës. Firmosa recetën me barnat qetësuese për xha Aliun, që vuan prej vjetësh nga tensioni, dhe pashë nga dritarja.

Në lokalitetin tonë poezia e bardhësisë pikëlon çdo vit. Koha vrenjtet e qielli nxihet, ia shkrepin vetëtimat e gjëmimet, litarët e shiut dridhen si gjarpërushë; pastaj vijnë acaret e cingërimat dhe më pas ia behin ciflat e imta a llapavece të borës. Kraharorët e njerëzve i ngop ajri i pastër, kalamanjtë rrëshqasin në kolovajzat e akullta, apo skalisin pleq dëbore.

Pashë orën. «Ajo duhej të kishte ardhur», — mendova. Muajt e fundit Lida, arsimtarja, kur zbriste në lokalitet të shtunave, ishte e pamundur të mos kthehej tek unë. Pastaj shkonim në klub dhe, me autobusin e linjës, ktheheshim në qytet. Atë ditë ajo do të më sillte një kukull për mbesën, dhurata ime për Vitin e Ri. Me këtë rast do të ktheheshim bashkë.

— Doktor!

— Urdhëroni!

Ktheva kokën nga erdhi zëri. Në derën gjysmë të hapur pashë një fytyrë të imtë, zeshkane, me një palë

mustaqe të trasha, që dridheshin te cepi i buzës. U afrua e më zgjati dorën e madhe e të ashpër.

— Kam një fëmijë të sëmurë.

— Sille ta shohim.

— Ta sjell, po nuk e kam këtu. Jashtë po bëhet kiameti. Si do të bëjmë?

Heshta. Instinktivisht sytë më shkuan tek ora. Lida duhej të kishte ardhur ose do të vinte nga çasti në çast. Damarët më kërcyen në tëmtha. Atë ditë dhe unë isha tepër i dëshiruar për të. Kohët e fundit, ditët e javës në lokalitet (sidomos kur s'kisha shumë vizita) më dukeshin vërtet të gjata, dhe ndaj mezi e prisja të shtunën. Sidomos atë të shtunë doja patjetër ta bëja rrugën me të. Një javë më parë udhëtimi me autobus më qe dukur shumë i shkurtër. Tërë rrugën ma morën mëdyshjet e mia torturuese: t'ia them sot a të mos ia them? Ndoshta këtë të shtunë do të mund të bëja një hap përpara. Dy sytë e zinj të zeshkanit, nën harqet e trasha të vetullave, më ndiqnin në çdo lëvizje. Burri më zgjati kutinë me duhan të dredhur.

— Është shumë i fortë, — i thashë.

I kërkova Maries, që rrinte në anën tjetër të tavolinës, çantën e urgjencës dhe bëra të dilja.

— Nuk vonohem, — i thashë zeshkanit.

Flokët e borës m'u përplasën, ashtu të ftohtë e të lagësht, në mollëzat e faqeve. Hyra me vrap në klubin e stacionit. Ajri kundërmonte erë duhani. Kërkova mes njerëzve ndonjë nga shoqet e Lidës, po nuk më zuri syri asnjërin.

— Edhe një kafe për doktorin.

Dikush nga pas më rrahu shpatullat miqësisht. Ishte ekonomisti i lokalitetit.

— Nuk më pret puna, Qemal, — i thashë. — Erdha sa të marr një paqetë.

— Ti kështu e bën gjithmonë, — qeshi ai. — Sa herë dua të paguaj unë, je i zënë.

— Këtu jemi prapë, — u përgjigja.

Mora në banak një «Ardian» dhe dola nga klubi. Ciflat e borës fluturonin me rrëmujë sa andej-këndej e përplaseshin në pallto e fytyrë. Gjithçka po zbardhte. Zeshkani po tymoste një duhan të dredhur në korridor. Çanta e urgjencës ishte gati në infermieri.

— U zbardhe, o doktor, — murmuriti Maria me të qeshur.

— S'ka gjë, — i thashë, dhe sytë më shkuan te pasqyra. Isha bërë si plaku i Vitit të Ri. Ky mendim më kujtoi Gencin në shkollën 8-vjeçare. «Po tani, në Fierzë, çfarë bën, a bie dëborë? — mendova. — Ç'do të thotë, po të më shohë kështu?»

Qesha. Zeshkani pas shpine më shihte me habi. E ndjeva se po e teproja me filozofimet e mia të yshtyra nga dëborra dhe Lida.

— Shkojmë, — i thashë, dhe sakaq u gjenda përtej ambulancës. Ngrita jakën e palltos, struka qafën mes shpatullave e ngava hapat.

— Kur u sëmur fëmija?

— Ka një javë, me kollë e të nxehtë. Dje pati të vjella, sot e lau barku fare.

Në përfytyrimin tim doli një fëmijë i dobët, i zbetë. Mendoja atë që më priste atë ditë mes erës që frynte dhe dëborës që nuk reshtte. Këto më ngacmonin fantazinë, sa herë që merrja çantën e urgjencës. Truri bluante rastet më të vështira, për ta pasur më të thjeshtë udhën e zgjidhjes.

— Do të ftohesh, o doktor. Sa të vemi në shtëpi, pa di unë se ç'bëj.

— S'ka gjë, kalon dhe kjo.

— Nuk do të ta harroj kurrë.

E njihja bujarinë e fshatarëve të këtyre anëve. Në verë e kisha shkelur kushedi sa herë këtë rrugë, ia njihja të gjitha hollësitë. E dija se aty përbri, te bërryli përtej një ure të drunjtë, në rrënjët e kumbullës gjatore, ishte një burim i ftohtë akull, ku ta kishte ënda të haje bukë e të rrije. Pas gjysmë ore ndiheshe i uritur, zorrët të kërcisnin, si të mos kishe futur gjësendi në gojë. Kjo rrugë më ndillte kënaqësi.

Era sikur u tulat dhe dëbora u bë më e thatë, më e imtë. Burri nuk fliste. Unë — më shumë se ai. Isha zhytur i tëri në pallton e trashë dhe fërkoja herë pas here faqet e akullta dhe majën e hundës në supe. Këmbët m'u bënë si të drunjta, megjithatë ecja shpejt që të më ngroheshin sadopak. Atje në qytet, nëna, që e dinte se do të kthehesha, do të merakosej për vonesën time. Ajo është mësuar me urgjencat e mia, po prapë rri zgjuar e pret të trokasë dera gjer në agim, me kuvertën hedhur krahëve, pranë sobës. Mendimet më shkuan te fëmija.

— Po fëmijën si e le? — i thashë.

Burri u drodh, sikur u pre fare; si duket në trurin e tij kaloi një mendim i keq.

— Kam frikë se nuk do ta gjejmë.

— Si, ore? Pse e latë kaq shumë?

— Gruaja donte ta sillte, po nuk donte nëna. Është e shkruar, thotë. Ajo i bëri të sajat, por nuk doli gjë.

— Ta kishit sjellë në spital.

— Në spital? Jo, jo. Nëna nuk do. Ime shoqe nuk flet, po prapë ajo më shtyu të vija te ti. Na duket tmerr ajo derë. Vërtet i shpëtoi fëmija Diles aty, po kjo ishte për të. Ne jemi plagosur dy herë. Vatra jonë nuk e ka ndier qarjen e fëmijës më shumë se një vit. Na vdesin. E përse ta shpiem në spital?

— Si të mos e shpini? — sa nuk i bërtita.

— Po qe nisur për të vdekur, o doktor, do të vdesë

se s'bën, edhe sikur përpjetë të hidhesh, — tha burri e ma bëri me dorë të mos e zgjasja.

— Nuk është ashtu...

...

Në hajat u ndien hapat dhe zërat tanë. U hap dera. Një grua me flokë të prishur na doli përpara. Dukej e shqetësuar nga ankthi i pritjes.

— Erdhi?

Zeshkani pohoi me kokë. Gruaja u derdh të më merrte pallton, por unë nuk pranova. E hoqa dhe e shkunda në hajat. Flokët e butë të dëborës u derdhën në dyshe-me. Pastaj ia dhashë gruas. Ajo e vuri pas derës dhe më zgjati peshqirin. Fshiva kokën me të dhe hyra në dhomë. Ajo ishte e thjeshtë: me dy krevate të drunjtë në fund të dritareve, me një sobë, ku brambullinte zjarri, dhe me një djep, që po e tundnin. Një plakë e shëndetshme; veshur me të zeza, me djepin mes gjunjëve, rrinte pranë derës së hapur të sobës, që qe skuqur nga prushi. Iu afrova. Plaka u çua e më liroi vendin. Një rënkim doli nga batanija gri e djepit.

— Vëre këtu, — i tregova me kokë krevatin e drunjtë.

Gruaja bëri si i thashë. Nga profili m'u duk si fytyrë e parë.

— E ke zbritur ndonjëherë në lokalitet? — e pyeta.

— E kam zbritur, si nuk e kam zbritur! Para dy muajsh e ke parë. Më the të mos i jap më paluze, por t'i filloja muhalebinë, kosin. Fëmija mori për mbarë atëherë, por tani... — kafshoi buzën e tundi kokën.

Nxora stetoskopin nga çanta. Plaka zgjeroi kokërdhokët e syve.

— Ç'do t'i bëjë, moj nuse? — i pëshpëriti.

— Do ta vizitojë, nënë!

Vura dorën mbi ballin e fëmijës. Ai digjej zjarr.

Herë-herë lëvizte doçkat dhe i fuste në gojën e vogël. Sytë e vegjël, në mes të rrathëve të zinj, e kishin humbur shikimin. Kërkova një pecetë dhe një pjatë me ujë. Pecetën e shtrydhur ia vura në ballë.

— Do të ftohet më tepër, — u hodh plaka.

— Më sillni ujë të zier dhe çaj, — thashë.

Gruaja i solli menjëherë. Siç duket, e mbante mend qysh atëherë kur e zbriti fëmijën në lokalitet. Drutë kërcisnin në sobë. Dhoma ishte aq e nxehtë, sa, po të mos kishe qenë jashtë, do të kujtoje se ishte një ditë e nxehtë korriku.

— E keni shtrënguar shumë, — thashë dhe lirova batanijen. Dora më zuri në një send të fortë. E pashë. Një leckë e lidhur kotkë, e qepur me penj të bardhë. E shqepa që aty dhe e hodha në kënd. I pashë vëngër. Zeshkani buzëqeshi, si i zënë në faj, dhe uli kokën. Raste të tilla më takonin në vizitat e përditshme. E kisha rrahur këtë temë me kolegët e mi. Bertit, kur i rastisnin të tilla, i hapte në sy të nënave dhe zemërohej më keq se unë. Po a ia vllente të bëja fjalë tani, kur fëmija kishte nevojë urgjente për ndihmën time?...

Zëri i dobët, i ngjirur i fëmijës, më ngacmonte mendimet, më fuste në një udhë pa fund. Asnjëherë nuk e kisha parë veten kaq ngushtë. Kërkova në çantë shiringën, kafeinën, ultrakortenin. Nuska kishte mbetur akoma në kënd. «Ajo po e hante ngadalë, — mendova, — po e brente, po e kafshonte ku mundte». Vura lugën me çaj në buzët e thara të fëmijës. Kokërdhokët e syve më ndiqnin të etur, dhe goja hapej e mbyllej vazhdimisht.

— Ka nevojë për ujë, — thashë dhe i vura në buzë një lugë tjetër.

— Ma jep mua, ma jep! — tha gruaja dhe ndryshoi ngjyrë, kur pa fëmijën të çelëvitej. Bëra më tej, pa ia hequr sytë fëmijës. Nuk më linte një mendim. Bronko-

pneumonia dhe dispepsia donin serume dhe antibiotikë. Çaji dhe uji i zier ishin si një behar i vogël në një dimër të madh. Duhej gjetur rruga që kësaj nëne t'i flitej për spitalin. Burri rrinte në një cep të krevatit e nuk ndihej. Pastaj, siç duket, iu rëndua kjo heshtje, i dha krahë gjallëria e fëmijës, se doli e u kthye me një shishe e dy gota.

— Ta dija se uji i zier e çaji janë kaq të bekuar... — tha zeshkani e bëri t'i dilnin dhëmbët e bardhë nga një e qeshur me gjithë shpirt. — Hedhim nga një që të na ikë e ftohta?

Mora gotën.

— Gëzuar! Të shkuara!

— Ta paçim hua, o doktor! Nuk u kurseve në këtë kiamet.

Sytë më shkuan në një kornizë fotografish, album i jetës familjare. Plaka me të zeza kishte dalë te porta e një shtëpie me një mesoburrë me rroba shajaku. Në një tjetër gruaja mbante fëmijën në krahë. Ai qeshte e kishte zgjatur duart përpara, si të kërkonte diçka (truk i zakonshëm ky për fotografët në fiksime të tyre). Një klithmë më shkëputi nga soditjet. Fëmija vulli. Gruaja ngeli si e ngrirë me lugën në dorë. U sula dhe e ktheva brinjazi. Ai e nxori prapë ujin si shatërvan. Plaka me gruan lebetisnin e shkulinin flokët. Burri ngeli me gotën e shishen e rakisë në dorë. Pastaj e la në krevat. Nga gryka e hapur e shishes, rakia u derdh me gurgullimë në batanijen e grinjte. Askush nuk u mundua ta ngrinte.

— Po më ikën djali, o doktor! — klithi gruaja.

— Nuk i mban gjë stomaku, — psherëtiva. — Duhet t'i bëjmë serum.

— Ç'të duash t'i bëjmë, — tha gruaja, — vetëm të shpëtojë. Vete im shoq e merr në farmaci.

— Nuk është në farmaci. Atë e kemi në spital.

Plaka tundi kokën në shenjë mohimi:

— Të japë shpirt në spital? Jo, jo! Do t'ia mbyllë sytë nëna e gjyshja.

— Ç'të bëjmë, doktor, ç'të bëjmë? — tha gruaja.

— Duhet ta shpiem patjetër. Aty do të shpëtojë.

E mëkoja më rrallë. Fëmija pinte i etur.

— Ai ka nevojë për ujëra, nënë! Në spital ia japim me gjilpërë e nuk torturohet fëmija kështu. Sa të vijë makina, pa zgjidhet puna.

— Ç'makinë?

— Ambulanca. Lajmërova që kur isha në lokalitet. Tani do ta kërkojmë prapë. Vishu, — i thashë zeshkanit. Ai mblodhi supet, po nuk foli. Në të vërtetë, unë nuk e kisha kërkuar makinën në qytet. Dhe zeshkani e dinte këtë. Dolëm në errësirë dhe shkuam te dezurni. Nga receptori erdhi zëri i infermierit të rojës.

— Kush je?

I thashë kush isha.

— Është kohë e keqe, o doktor, po do ta nis që tani.

— Ta marrë djalli, ta marrë. Ku na ndjekin dhe ne këto, — shau burri nëpër dhëmbë.

Shkuam në shtëpi. Plaka i fliste së resë.

— Kot që ta shpiem, moj nuse.

— Si të mos e shpiem, moj nënë. Ai erdhi gjer këtu e ne të mos e dëgjojmë!..

— Ç'do t'i bëjnë aty... .

— Ai e di. E shikon? Kur e ushqen ai, fëmija nuk vjell. Sa i jap unë, prishet në fytyrë e nxjerr tërë ato gryka uji, sikur t'i japim pelin e jo çaj.

Heshtën të dyja kur më panë në derë.

— Volli prapë, — tha gruaja pas pak.

— Ushqeje më rrallë.

Ajo bëri si i thashë. Nuk më shpëtonte asnjë lëvizje në fytyrën e fëmijës, të gruas e të plakës. Koha çapitej me hapa përtacë.

— Shiko, në duket makina, — i thashë zeshkanit.

Ai doli pa bërë zë. Dhe plaka pas tij. Mora lugën e fillova të pikoja çajin në buzët e thara e të plasaritura. Po a mund të shuhej etja e një të përvëluari me pikatore?! Fotografia, buzëqeshja e fëmijës më ndiqnin pas. Sikur e shihja të pasqyruar në çdo pikë uji që rrëzohej në buzët e zhuritura. Dhe ata dy të tjerët kanë vuajtur për këto, mendova. Ndoshta kanë qenë në kornizë, por i kanë hequr. Zemra e plagosur e nënës sfilitej për njomësinë e tyre.

— Do të shpëtojë, doktor, po ta shpiem aty? — pyeti gruaja.

— Të siguroj unë për këtë, — i thashë. Ndonëse gjendja e fëmijës ma luhaste këtë mendim, prapë nuk e dhashë veten.

— Erdhi — u fut zeshkani si erë.

Plaka vuri kujën dhe iu turr fëmijës.

— Trim i nënës! Oxhaku i nënës! Na mbylle derën!

Lotët e nënës më futën mornica në trup.

— Shkojmë, nënë! Ti do ta puthësh prapë nipin, — i thashë.

— Gajret më jep, o bir, pa ajo që thua ti nuk bëhet. Se kush i ha fëmijët në sy këtu dhe na mbyll derën!

Dolëm. Dëborë kishte pushuar dhe era ishte tulatur. Hipëm në makinë. Shofer Nazmiu kërkonte paqetën në xhepa. I dhashë një cigare. E ndeza dhe unë. E thitha fort me tërë mushkërinë, pastaj e nxora njëherësh tymin e hirtë, si të largoja ankthin që më rëndonte si plumb në kraharor. Nga xhami i përparshëm i makinës shihja brazdat e rrotave, vizuar në bardhësinë e paanë, në mes të shelgjeve të zhveshura të rrugës. Gjurmë kafshësh ndanin në mes ato vija paralele.

— Dhelpra të jenë? — thashë.

— Çfarë dhelpira! Ujqër! Zihen e kafshohen me njëri-tjetrin dhe e kanë shirë borën si gurin në lëmë.

Filloi të frynte. Një borë e imtë, e thatë, lëshohej parreshtur në qilimin e butë. Nga velloja e bardhë ngrihej në transparencën e xhamit një si re e hollë mjegulle. Herë-herë gruaja ngrinte batanijen për të parë fëmijën në merrte frymë, seç murmuriste dhe në sytë e saj shprehej padurimi.

— Ma jep mua, — tha plaka.

— Nuk jam lodhur, nënë!

Ky dialog më shqetësonte. Si do të shkonte fëmija? A do të arrinte të merrte mjekimin? Do të shpëtonte? Këto pyetje më ngacmonin dhe kërkonin përgjigje. Edhe ata gjashtë sy, në fund të makinës, nuk ishin indiferentë.

Nga udha tërë gropa, që humbiste dredhave, makina u kthye në xhadenë e asfaltuar. Nazmiu ndërroi marshet e rriti shpejtësinë. Pas pak qyteti doli para nesh. Dritat ngjanin me pirgje zjarresh që digjeshin pa pushim. Neonet, si bastunë, ndriçonin bulevardin. Boria gjëmoi te dera e spitalit. Portieri hapi kanatet. Në urgjencë ishte doktor Astriti.

— Ç'solle?

— Një rast tepër urgjent. T'i futet një herë serum, pastaj mbushim kartelën.

— Si të duash, — tha ai.

Ata rrinin te dera e pavionit.

— Ç'do të bëjmë? — tha gruaja.

— Prisni këtu.

— Unë dua të shoh djalin, ndryshe e marr në shtëpi, — u hodh plaka.

— Prit, moj nënë, të mbarojë mjekimet. Pastaj nusja do të rrijë me të.

Ndeza një cigare. Diçka e panjohur më shtrëngoi në fyt. Është pritja sa të jepet rezultati i mjekimit. Kjo ia

kalon çdo provimi. Kimia organike, fizika, anatomia patologjika, terapia nuk janë gjë para saj. Nga dhoma doli Astriti. Qeshi kur më pa.

— Po e merr veten, — tha.

Buzëqesha. Më erdhi ndër mend Lida. «A do të ketë ardhur sonte?» — mendova. Hyra në dhomën e pritjes. Plaka u çua nga stoli.

— A do të bëhet, doktor? — më pyeti gjithë ankth.

— Si nuk do të bëhet. Përse erdhëm ne këtu?

— Sikur s'më besohet.

— Do të shohësh.

Nuk më hiqeshin nga mendja të papriturat. Shkova në dhomën e mjekut. Astriti lexonte. E la revistën mënjane e më tha të ulesha.

Pastaj erdhi një infermiere dhe e thirri. Ngela vetëm. Sikur më vriste kjo vetmi. Shkova prapë në dhomën e fëmijës. Gruaja kishte mbështetur krahun në krevat. E kishte marrë gjumi. Hoqa napën e bardhë nga fytyra e fëmijës dhe pashë ngjyrën e jetës në sytë e tij. «Do të kalojë», — mendova.

Tej dritares ciflat e borës i vërtiste era.

A NUK DO TA FITOJMË NE LUFTËN?...

A ka nënë të pickojë fëmijën e saj kur ai nuk ka shkatërruar gjësend, kur nuk është pleksur me ndokënd? Patjetër që jo. Por ka dhe raste që e bëjnë këtë punë. Ja, fjala vjen, kur ajo është për vizitë te të njohurit bashkë me fëmijën dhe befasi ndien ngrohtësinë e lagësht t'i rrjedhë në duar përmes pelenave. Atëherë nëna zemërohet; dashuria e saj e paroitur për fëmijën lajthit një çast dhe, ashtu e skuqur, e turpëruar për diçka të pahijshme për vendin, por të zakonshme për moshën, ajo nuk i kursen dackat dhe pickimet. Kur britma therëse që del nga pelenat i shpon veshin e i ther zemrën, pendohet dhe e mbulon me përkëdhelje e të puthura.

Dhe nëna ime më ka pickuar një herë fort, aq fort, sa dhe memeci do të kishte lëshuar zërin e do të kishte vënë kujën.

Kështu më foli nëna pas vitesh. Pickimin nuk e diktoi mosha, tjetër gjë ishte... Dhe unë po mundohem ta tregoj ashtu si e kam dëgjuar nga ajo...

Ishin vite lufte, vite të trubullta, vite të pasigurta. Tendosjen e nervave njerëzve nuk ua ulte as mëngjesi, as buzëmbremja kur zinin e kërcisnin portat e drunjtat. Patrullat fashiste ndiqnin lëvizjet më të imta të kalimtarëve. Për çdo dyshim të drejtonin tytata e automatikëve dhe të thërrisnin me të vrazhdë.

— Il dokumento!¹⁾

Si shuanin frikën e komunizmit nga xhepat e zbrazët e nga letrat, shanin në gjuhën e tyre dhe godisnin ku të mundnin. Pastaj trak-traket e këpucëve me gozhdë vazhdonin tingujt monotonë në kalldrëmet e ftohta dhe të heshtura. Një farë ankthi, pasigurie u ngjall në qytet. Puna niste ndaj të gdhirë e mbaronte para se të binte muzgu. Mbrëmjeve sikush mbyllej në vatrën familjare. Binte të flinte, por trokëllimat e çizmeve e të grushtave, zërat e çjerrë, që hera-herës i shoqëronte kërkëllima e zgjatur e automatikut, e linin syhapur gjer në mesnatë.

— Ej, ju aty, shuani dritën, se jua mbushëm barkun me plumba!

Kërcisnin xhamat e thyer, fluturonin gurët në dhoma, kur ndokush harronte të mbulonte dritaren dhe ndonjë rreze drite luhatej në gurët e ftohtë të kalldrëmit. Drita shuhej me të shpejtë, zemrat sikur i pushonin rrahjet dhe prisnin ç'do të sillte minuta. Po trokëllima e këpucëve, sharjet në gjuhën e vrazhdë ndiheshin më larg, në rrugicën tjetër.

Në dyert e shtëpive dhe në faqet e mureve filluan të ngjiteshin ca letra shpresëdhënëse që flisnin për qëndresë. Armiku bëhej më i egër, më nevrík dhe e humbte shpesh arsyen dhe logjikën e «shpëtimtarit». Në dhoma dhe bodrume flitej shpesh për këtë.

Thyheshin mbrëmjet, dhe nga malet e Moravës dielli dilte përsëri për të parë se ç'bëhej në qytet. Kohët e fundit, një frymëmarrje tjetër kishte qyteti, më të çlirët, më të sigurtë. Këtë e shihte dhe disku i diellit që ngrihej lart, dhe ata që mblidheshin kokë më kokë nëpër shtëpira e dilnin në mesnatë, dhe ata që trokëllinin netve në

1) (it.) — dokumentin.

rrugë. Në këto mëngjese dhe mbrëmje të shqetësuara malet, më shumë se kurrë, ishin lidhur me qytetin. Në periferitë e tij lëviznin korrierë, dilnin armë, barna mjekësore, trakte që shaptilografoheshin bodrumeve të errëta. Malet dhe fshatrat ishin si toka e Anteut për komunistët. Armiqtë e ndienin se po u rrëshqiste toka nën këmbë dhe krijonin gjendje shtetrrëthimi. Nuk kalonte askush pa iu nënshtruar kontrollit. Transportimi i armëve, i barnave mjekësore bëhej më i vështirë. Prapëseprapë ato dilnin përtej gardhit të ngjeshur të fashistëve.

Ato ditë në qendër të qytetit ishte vrarë një spiun. Fashistët i ndoqën këmba-këmbës atentatorët, por nuk mundën t'i kapnin. Arrestuan kë gjetën rrugës dhe mbushën burgjet me njerëz të pafajshëm.

Miçoja, që babai e dinte se ishte nga të njësitit guerriil, erdhi një mëngjes në dyqan.

— Punë të mbarë, usta!

— Mbarë paç, — iu ktheu babai buzagaz. — Ç'erë e mirë të fryu këtej, o Miço?

— Lufta, Jorgo, lufta, kush tjetër! — iu përgjigj ai.

— Hë, ç'kemi? — Babai e dinte se Miçoja nuk vinte kot.

— Tridhjetë palë këpucë duan ata të malit për dhjetë ditë.

Babai la kudrën e çekanin në tavolinën e punës dhe shtriu krahët.

— Si shpejt është...

— Shpejt, thua? — ia bëri Miçoja. — Nuk e dëgjon se ç'bëhet! Përditë zanatçinjtë dhe studentët e liceut po e marrin vesh se hallet e tyre do të mbarohen, vetëm po të dalin malit.

— Të dal edhe unë? — tha babai.

— Tani për tani, jo. Na duhesh këtu ku je. Shokët e malit të mbajnë në gojë për këpucët e para...

Babait i shkuan sytë te maja e shqepur e këpucës së Miços, ku dilte gishti i madh nga çorapja e grisur.

— Po ti, këpucë mbledh e këpucë s'ke? — i tha babai me qesëndi.

— Të kenë ata njëherë, se baresin ditë e natë në dëborë e shi, pa edhe ne do të kemi.

— Atë do ta bëjmë se s'bën. Që sot po shkoj nga Taqoja.

Çdo kërkesë që vinte nga mali për këpucë, ata të njësitit guerril ua linin babait dhe Taqos, që e kishte dyqanin në rrugën tjetër. Ata fusnin në torbë lëkurën e shollën pasi mbyllnin dyqanin dhe punonin në qilar deri vonë (në dyqan bëheshin kontrole të shpeshta).

Miçoja iku shpejt. Nxitonte. Kapërceu shkallët dhe u fut mes turmës. Bëri dy hapa dhe ndali papritmas. U fsheh pas barkut të një kali, që ishte lidhur në një shtyllë dhe u kthye në dyqan.

— Eh? — tundi kokën babai.

— Lëvizin tepër.

— U ka hyrë frika në palcë.


— Sot në mëngjes hodhën prapë trakte.

— S'ke ku shkon, — i tha babai dhe sytë i vanë te këpuca. — Hiqe atë, hiqe, t'i vë nja dy gozhdë, se është hapur si gojë ujku.

Miçoja pa nga dritarja. Në sheshin e kalldrëmtë fshatarët tregtonin drithëra, fruta, perime. Uniforma ushtarake vinin rrotull tregut. Herë-herë fusnin duart në thellësinë e thasëve dhe bërtisnin:

— Ku e ke futur, ku?

Fshatarët, si të mos kuptonin përse bëhej fjalë, ngrinin supet të habitur. Këmishëzinjtë villnin gjithfarë vreri për komunistët e komunizmin. Kjo ishte e keqja më e vogël. Rreziku më i madh fshihej tek ata që mbanin



rroba civile e që bënin sytë katër të hidhnin grepin diku. Një të tillë kishte parë Miçoja, pa ishte kthyer. Hoqi këpucët në mëdyshje, dhe në dyqan kundërmoi era e fortë e djersës, që të zinte frymën. E la te pragu, që ajo të hapej sadopak dhe u ul në fron, buzë dritares.

— Po vjen, po vjen maskarai! — Miçoja u çua i shqetësuar dhe u mbështet pas murit që ndahej me sobalkën. Babai godiste mbi kudër, po i kapi shpejt fjalët. Lëshoi këpucën mes gjunjëve, i tha Miços të futej në sobalkë dhe që andej të zbriste në bodrum. Vuri një palë këpucë të reja në prehër dhe pa vëngër nga xhami. Dy-tre metra larg derës, në të majtë, Ramiu kishte ndalur te thasët me misër të një fshatari. Nuk ra në ujdi, se ngrysi vetullat dhe hodhi i nevrikosur një grusht misër në grykën e hapur të thesit dhe, duke u ngërdheshur, hyri në dyqan.

Babai u tremb. Ai duhej ta kishte parë Miçon. Ishte një qelbësirë, që s'linte gjë t'i shpëtonte, shok i atij që u vra në qendër të qytetit. Kurrë nuk vishte rroba ushtarake, po të rrinte me ta, ia kishte qejfi. Eh, sa njerëz kishte marrë në qafë! Tani i erdhi radha Miços. Ndoshta e kishte parë në atentat dhe i kishte ardhur në shteg. Pasi të shihte katër muret, ai do të hapte sobalkën dhe do t'ua bënte me shenjë ushtarëve që prisnin rrotull tregut. Ai që ishte brenda, nuk kishte nga t'ia mbante. Babai padashur e kishte futur vetë në kurth. Miçoja kishte revolver me vete, se babai e kishte parë të kërkonte nën xhaketë, po ç'do të bënte ajo grykë e vetme, kur mbi kalldrëmin e tregut kishte më tepër fashistë se gurë?.... Ndoshta nuk e kishin parë, vetëm dyshonin. Babai do t'u thoshte se s'kishte parë njeri. Po të kontrollonin e ta gjenin Miçon në bodrum, do t'u thoshte se e njihte vetëm si klient të rregullt. Po sikur t'i gjenin revolverin e ndonjë gjë tjetër?... Apo s'ishte një dhelpër ky Ramiu!

Ndaj të gdhirë, kur hapi dyqanin, babai kishte gjetur poshtë derës një trakt. Në të flitej për tre komunistë që kishin luftuar si burra me një dynja fashistësh në Veri dhe që spiunin e kishin vrrarë. Shok i tyre ishte dhe Miçoja: nuk binte lehtë në dorë ai, jo! Po pse e futi në bodrum? Ta kishte lënë të dilte nga dyqani dhe të kalonte pa u ndier, ose t'ia therte vrapit. Mendimin e fundit ia larguan fashistët që vinin rrotull tregut. Hajde, luftë që do të bëhej! Në djall dyqani, vetëm ai të shpëtonte, ai. . .

Kërrusur mbi kudër, babai godiste kot në këpucë, po mendja i rrihte gjatë.

— Shollë e mirë kjo, hë? — pyeti Ramiu, po sytë nuk i hiqte nga dritarja.

— E mirë është.

Babai ngriti sytë nga kudra dhe ndoqi vështrimin e tij përtej xhamave. Askush nuk shikonte nga ata. Sytë e Ramiut shkanë në parvazin e dritares, ranë në tubin e shollës, në faqet e mureve dhe u ndalën te dera e sobalkës.

«Tani, — mendoj babai, — tani. . . Bukur po e luan, kërma!»

— Po të rrahësh dhenë si Gaqo tregtari, gjen mall të mirë, — tha me zë të lartë. — Sot e mora. S'më kishte mbetur asnjë copë. Mos do një palë? Nuk e kam futur brenda. Ja ku e ke. Zgjidhe, kë shollë do?

— Sa bën? — pyeti Ramiu.

Babai ia tha.

— E paske ulur. I ka rënë vleftha shollës.

— Sa për atë, shko e pyet Gaqon. Ia mora sa frëngu pulën, po për klientët e vjetër ka zbritje.

Ramiu qeshi. Tha se komunistët ishin ata që sillnin ngatërresa.

— Po ata pse nuk vënë rregull? — Babai tregoi me kokë jashtë derës, ku kishin ndaluar dy ushtarë dhe po ndiznin cigare.

— Ja, sikur e kanë vënë. Do t'i fshijnë nga faqja e dheut komunistët, po është shpejt akoma. Struken si kërmij në shpellat e maleve.

Babai i kujtoi atentatorin. Ramiu tha se e kishte parë atentatorin në pazar, se të gjitha rrugët ishin zënë, pastaj shau nëpër dhëmbë dhe doli pa u ndier.

Babai mori frymë i lehtësuar, po mendimi i ndonjë dredhie nuk iu nda. Ramiu shkoi prapë te fshatari me misër. «Miçoja dihet që është në pazar, po jo në dyqan», — mendoi. Dhe si iu mbush mendja që Ramiu u largua, rrëmbeu tubin e shollës e kaloi në sobalkë .

— Të kishte parë, — i tha Miços, që doli nga bodrumi.

— E dëgjova, e dëgjova. A u qërua që këtej?

— Akoma vjen rrotull.

— Nepërka! — shau Miçoja. — Ia tregojmë ne...

Nxori revolverin nga xhepi i brendshëm i xhaketës, i fryu te gryka, si të thoshte se do të mbaronin punë shpejt me të, dhe u ngrit.

— Nuk duhet të shkosh, — tha babai. — Ata duhet të jenë këtu deri ndaj të ngrysur. Dridhe njëherë, — dhe i zgjati kutinë e duhanit.

— Jo, jo. Shokët presin lajmin e këpucëve dhe këtë. — Një pako e mbështjellë me gazetë rrëshqiti nga xhepi i pasmë. — E pamundura duhet bërë. Në mesditë duhet të jem jashtë qytetit.

— Duhet, po... shiko.

Miçoja afroi syrin te një plasë e derës së sobalkës. Përtej xhamit lëviznin fashistë.

— Si t'ia bëjmë?

U ulën mbi tubin e shollës e po thithnin cigaret.

— Më duket se e gjeta, — tha babai dhe qeshi.

— Hë...?

Duke më mbajtur në krahë, nëna hyri në dyqan dhe iu zbraz babait.

— Mirë mua, po kalamanin pse e kërkon? Kështu më tha ai djali që kishe dërguar. Po qe puna për doktor, nuk më lipset më. E shëruan ilaçet e Gjenkës.

Babai i tha të ulej. Kur doli klienti i fundit, mbylli derën dhe shkuan në sobalkë. Biseduan me Miçon, hapën pelenat ku dremisja unë dhe mbështollën paketën.

Te postblloku milicët e ndaluan nënën.

— Ku shkon, moj zonjë? — i thirri njëri me qesëndi.

— Te babai në fshat. Është sëmurë.

— Tani në kohë lufte?

— Ku ka kohë sëmundja... Është zënë ulok nga reumatizmi.

— Po yt shoq si të lë kështu?

— Punon ai, — tha nëna.

— Ëhë, mos shkon ta takojë në mal... — u hodh një tjetër duke qeshur.

— Ha, ha, ha...

— Kontrolloje, kontrolloje, — tha njëri me veshje oficeri. — U bënë të gjithë komunistë tani. Nuk rrinë pranë zjarrit, po lezetosen me cikmën e maleve!...

Heshtje. Një milic iu afrua nënës, i rrëmbeu çantën dhe e ktheu përmbys. Ndërresat e mia ranë përtokë. Ai i hapi një për një me majën e bajonetës.

— Nuk ka gjë, sinjor tenente.

— Kontrolloje! Kontrolloje!

Nëna e kishte pisk. Fyerjet i duroi, po ç'do të ndodhte më tej? Do të vinin dorë mbi të, do t'i hapnin pelenat fëmijës dhe, kur të gjenin paketën, do ta përplasnin përtokë, sa t'i hapeshin trutë. Ajo kishte dëgjuar se ata i torturonin fëmijët në sy të nënave. Do t'i thyhej e copëtohej zemra, së gjores, kur të jetonte këtë skenë të llaharshme që do ta ndiqte pas tërë jetën. «Kush ta ka dhënë, kush? Kërbaçi do të binte mbi të. Një rrëqethje i ka-

loi në trup. Më mbështolli në kraharor, si të më ruante nga ato vështrime të ftohta e të egra. Befas i vegoi një mendim dhe më pickoi fort në kofshë. Unë ia shkrepja të qarit.

— Po ç't'i shohësh kësaj! Është veshur beharçe...

Oficeri goditi me shqelm ndërresat e mia dhe ktheu kurrizin tërë inat. Ato flutruan në ajër dhe ranë më tej si parachuta. Milici më zbuloi fytyrën dhe më shtypi hundën. Nënës nuk i mbeti pikë gjaku në fytyrë. Pastaj ai nxitoi pas oficerit që zuri t'u çirrej dy fshatarëve.

Nëna kaloi postbllokun dhe ndaloi te një kishë e vogël, buzë xhadesë. Një burrë trupmadh me një pallto treçerekëshe shajaku, ulur këmbëkryq përtypej mbi një shami larushe. Një autokolonë me ushtarë kaloi me uturimë e ngriti pluhur në rrugën e heshtur.

Nëna i kërkoi fshatarit një copë bukë për mua, që akoma nuk kisha pushuar të qarët. Ai i tha se ishte misërnike dhe nuk bënte për dhëmbët e mi të porsadalë. Pastaj nëna e pyeti:

— Mos je Kalemi i Metajve?

Sytë e zinj të burrit shkëlqyen.

— Jo, jam Nevruzi i Shaqirajve.

Nëna i foli për Miçon, për mushkat që do të vinin pas dhjetë ditësh të merrnin këpucët, pastaj hapi pelenat. Burri hodhi paketën në torbë dhe u nda duke përshëndetur: «Vdekje fashizmit!»

Në postbllok milicët e njohën nënën.

— U kthye zonja.

— Mos është e kuqe?

— Si shumë po na vjen rrotull!

— Mos i pëlqen ndonjë nga ne?

Nëna hoqi çantën. Ata ia dhanë gazit.

— Lëre, ore, se ajo ka një fëmijë që...

Unë nuk qava. Lamë pas dërdëllitjet e milicëve dhe u kthyem në dyqan. Miçoja priste lajmin e nënës dhe mbrëmjen. Lëvizjet në treg ishin rralluar.

— Dhe yt bir në pelena u ngrit kundër tyre, — tha Miçoja e më nduku faqet. Unë flija i qetë. — Dhe thonë që jemi pak... A nuk jemi ngritur të gjithë, bashkë me kalamanjtë e djepit? Më thuaj, Jorgo, më thuaj, a nuk do ta fitojmë ne luftën?...

Z J A R R E N A T E

Vijëzimet e zinxhirëve të traktorit në udhën e pluhurosur, që dukeshin si qëndisma të një dore të shkathët e të palodhur, papritmas i humbën nga sytë. Makina u kthye në të majtë, në një lëndinë të butë e të pjerrët. Motori i Skodës vuri ulërimën. Plaku goditi me bërryl gjimnazistin, që, si dhe ai, ishte i ri në ekspeditë. Nuk e dinte në flinte apo shikonte i trullësuar tej xhamit të përparshëm të kabinës lëndinën që po shkelnin rrotat.

— Ç'ka? — kërceu djali i trembur.

— Shiko, shiko nga u fut, — i pëshpëriti në vesh.

Djali ngriti supet e rrudhi vetullat, si të mos kuptonte përse bëhej fjalë.

«Ky, do që të flerë, — mendoi plaku. — Ndoshta edhe shoferi». — Më duket se e ngatërruam rrugën, — tha me zë të lartë.

— Këtej urdhëroi inxhinieri. Edhe pak, dhe arritëm.

«Nuk fjetkërka, jo», — mendoi plaku dhe i erdhi turp që nuk i vuri fre gjuhës, po e la të shinte në kashtë.

Fashat e dritës rendnin nëpër bar. Motori u shua. Shoferi, një djalë i gjatë, i hollë, si ta kishin hequr për këmbësh, u var te dera e hapur e kabinës dhe mati me sy vendin. E ndezi përsëri dhe, si i dha makinës nja dy këmbë më tej, ndaloi.

— Këtu do të prisni, — tha me cigaren e ndezur te cepi i buzës dhe u ngjit lart. Pas tij hipi dhe gjimnazisti. Çadrat, dyshekët, batanijet, shtretet portative fluturuan në ajrin e freskët të mbrëmjes dhe ranë me një zhurmë të mbytur në lëndinë.

— Ato të tjerat më ngadalë, — tha plaku i merakosur.
— Janë enë kuzhine.

— Eh, se s'i gjen gjë, alumin janë, de! . . .

— E pse të venë dëm, kur e marrim shtruar? E ç'do të na gjejë, po të lozim këmbë e duar?

— Hajde, o plak, hajde, me vargje fole, — tha shoferi. I vuri enët mënjanë dhe ndenji aty deri sa kazanët, tenxheret dhe arka e ushqimeve u ulën në lëndinë. Pa dhe një herë për t'u siguruar se mos kishte mbetur gjësendi dhe, si iu mbush mendja që nuk kishte lënë gjë, kërcëu poshtë, mbylli pjesën e pasme të karrocërisë e ndezi një cigare tjetër.

— E pike shumë këtë të flamosurin, — tha plaku.
— Unë kaq u bëra, dhe s'më gjen pikë nikotine në mushkëri.

Fasha e dritës shkundi krifën e verdhë nëpër bar e shkurre dhe u lëshua me vrap tëposhtë luginës. Të porsaardhurit ndenjën pa lëvizur derisa makina u zhduk te bërryli dhe ulërima e motorit nuk u ndie më.

— Të vonohen, thua?

— Ku ta di unë. . . vende të parrapura këto. Mua më duket sikur më kanë hedhur me helikopter në këtë luginë, — tha djali dhe hoqi zvarë shpinën e dorës para gojës që i hapej.

— Unë kam bredhur qëmoti, po këto vende nuk m'i ka zënë syri. Kur iu ngjitëm kurrizit të malit, kujtova se do të rrëkëlleheshim në greminë. Nuk shkohet me makinë këndeje, jo. Këmbëve iu beson më tepër.

— Megjithatë, kaluam.

— Kaluam, po si kaluam, ama! Ti bëje gjumin e parë, or bir, dhe nuk pe se si për pak sa nuk fluturuam nga kabina.

— Kjo nuk është asgjë para Llogarasë. E pashë vjet kur shkuam vullnetarë në Ksamil. Nuk do të kesh kaluar andej, ndryshe nuk do të klithje ashtu, o xhaxha.

Plakut i lëvizi një damar në tëmtha.

— Rri rehat, djalo, se s'të kanë lezet këto fjalë. Kur kam baritur unë, ti as maces me lugë nuk dije t'i bije. Nuk ishte makina atëherë, jo, po këto na nxorën faqebardhë, — dhe u ra kafshëve me pëllëmbë. — Shoferi është xhanan e nuk i shtronte rrotat kot, por... Heshtim më mirë se kush na dëgjon, do të thotë se mua plakut më ka hyrë lepuri në bark.

Ata askush s'mund t'i dëgjonte... Kishin më se një orë që u vinin rrotull materialeve që kishin sjellë me makinë në atë luginë që mbështillej nga dy shpate malesh, dhe nuk vendosnin si ta kalonin natën.

— Shtrihemi? — tha djali.

Plaku e kishte parë rrugës sa herë i qe hapur goja gjimnazistit. Ky i kishte thënë se të djeshmen e kishte kaluar mbremjen në dasmën e të vëllait.

«Është i ri», — mendoi plaku. I tha të hapte shtratin portativ, të vinte dyshekun në të dhe të shtrihej. Djali bëri si i tha ai.

Hëna kishte mbështetur kryet në një re të madhe e të grinjtë. Kongjijtë e yjeve digjeshin pa pushim në hapësirën blu të thellë. Plaku kërkoi me hamendje çadrën, dyshekët, arkën e ushqimeve. Këmba i zuri në një send të fortë. Që aty u shkëput një tingull i shurdhët. «Ta marrë djalli, ta marrë. Këtu janë, ku do të venë...» — tha. U kujtua që djali flinte më tej dhe e uli zërin. «E mori gjumi shpejt, — tha me vete. — E lodhi dasma dhe rruga».

Iu kujtua nipi trembëdhjetëvjeçar që kishte shkuar me pushime në kampin e pionierëve në Pogradec. Gjeti një batanije mbi dyshek dhe ia hodhi sipër. Djali seç ngatërroi nëpër gjumë e mbuloi kokën. Hëna rrëshqiti nga reja e grinjtë. Një dritë e vakët, e zbetë u var nga qielli dhe u lëshua në lëndinë. Në fundin e një kazani të rrumbullakët ai pa hënën në miniaturë.

«Të kenë mbaruar punë vallë? — tha me vete. — Të ketë ardhur fshatari me ata të shuar gurë? Po kafshët a do të gjenden për nesër?»

Gërhitja e djalit të lodhur i erdhi si përgjigje.

* * *

Plaku nuk kishte qenë ndonjëherë në ekspeditë gjeologjike. Shkëputja e tij nga kuzhina në qendër të qytetit jugor ishte krejt e rastit... Nga sporteli i kuzhinës ai shihte klientët që hynin e dilnin në restorant. Kur vinin së dyti, ai e dinte se çfarë do të merrnin për të ngrënë dhe ua bënte gati, kur kamerieri i afrohej tavolinës së tyre. Njëherë erdhi në restorant një burrë i trashë, me syze dhe me çantë të fryrë. Gjellët ishin mbaruar në kuzhinë. Plaku i çoi turli, pastaj u ul në tavolinën e tij. Mësoi se burri me syze ishte inxhinier gjeolog, kishte ardhur me punë në qytetin jugor, pastaj do të nisej në një ekspeditë gjeologjike.

— Nga do të shkoni?

— Në male gjenden minerale. Është bukur aty.

— E di, e di, — tha plaku mendueshëm. Ai kishte bredhur mjaft në Malin me Gropa, në Qafën e Pishës në dy vjetët e fundit të Luftës. E njihnte mrekullinë e pranverës në sythet e çelura, ngrohtësinë e verës nën hijen e drurëve, ku zogjtë e pyllit nuk dinin të reshtnin cicëri-

mat, bukurinë e fletëve të zverdhura të vjeshtës, ashpërsinë dhe egërsinë e dimrit.

— Nuk patëm kohë t'i shijonim, jo, — tha prapë plaku ashtu mendueshëm dhe ndër mend i erdhën ditët e fundit të Luftës. Kompania e tij kishte zënë vend te pishat e Voskopojës. Mitralleri, tek vajiste mitralozin, kishte thënë i entuziazmuar:

«Do të ngjitem edhe një herë pas lufte këtej. Të ulem rrëzë burimeve ku kam pirë ujë, dhe të vë kapelen mbi sy. Betejat, pritrat, marshimet do të më dalin përpara dhe në këto fluturime të më zërë gjumi».

I kishte dalë nga mendja plakut të pyeste mitralierin, kur e kishte takuar në përvjetorin e brigadës, në kishte shkuar a jo. Për veten e tij ai kishte zbritur në qytet dhe nuk i pa më malet. U fut në një kuzhinë në qendër të qytetit jugor dhe ndenji me të birin. Gruaja i kishte vdekur qëkur. Më pas martoi të birin dhe lejën e zakonshme e kalonte me nipat e mbesat.

— Eh, malet, malet... Në zemër më çërit kur i kujtoj.

Burri me syze e kuptoi sa i dëshiruar ishte plaku për malet.

— A vjen me ne? — i tha. — Në ekspeditë na duhet një kuzhinier.

— Vij, ore, si nuk vij!

Dëshira për të parë vende të parrahura, për të rishkelur ato që dikur e kishin parë pa thinja, kur zemra i trokiste më shpejt dhe gjaku i lëvrinte në damarët e nxehur, iu ngjall përsëri. Bisedoi me djalin e nusen. Ata i thanë se tani ishte plakur e nuk i bënë këmbët. Plakut i mbeti qejfi. U tha se njeriut që punon, nuk i vjen pleqëria kurrë.

— Bëj si të duash, baba, — i tha djali, ngaqë nuk donte t'ia prishte.

Përgjegjësi i restorantit nuk i nxori telashe.

«Burrë i mirë», — mendoi plaku për inxhinierin. Po sot ia kishte prishur. Kur u ndalën në fshatin më të afërm, u futën në mensën e kooperativës. Plaku nguli këmbë të gatuarve vetë, por inxhinieri i kishte thënë se nuk u premtonte koha. Drekën e hëngrën aty. Gjella vërtet ishte e shijshme dhe as që lanë gjë në pjata, po atij nuk i shkoi që nuk i shkoi poshtë.

Inxhinieri me gjeologun shkuan në këshillin e fshatit të mbaronin disa punë të lëna në mes. Plakun me gjimnazistin e materialet i nisën në luginë. Inxhinieri kishte thënë se do të mbërrinte qysh atë natë. Të nesërmen do të ngjiteshin në Qafën e Luadhit me kafshët.

* * *

Kishte filluar të ftohej. Barin dhe gjethet e drurëve po i spërkaste vesa. Dyshekët, batanijet, kazanët dukeshin si të qëndisur me argjend. Plaku kaloi pëllëmbët mbi ta. Të rrëqethura i kaluan në trup. Djali gërhiste. Ai u mbështoll me batanije dhe u çua në këmbë. Hëna u ngul në kreshtën e malit si një glob i madh, i verdhë. Lugina, që dukej si e veshur me një mantel gri të errët, sikur i çeli sytë e përgjumur. Nga degët dhe fletët e ahut një fëshfërimë e lehtë ndillte të ftohtët e mesnatës. Ai ngjeshi qafën e shkurtër e të trashë mes shpatullave të gjera, ngriti jakën e xhakëtës dhe u fut në pyllin rrëzë luginës. Kapi një degë ahu. E ktheu sa andej-kënde, po nga ajo nuk doli ndonjë krismë.

«Bisk i njomë, — tha me vete. — As për zjarr nuk bën». Kur i sillnin të tilla në kuzhinë, ai grindej me ata të komunales.

Bëri më tej. Një krismë e shurdhët, e thatë i erdhi në

vesh. Ishte ngatërruar me ca karthia. «Duhet ndezur zjarr, — mendoi. — Të than e të kallkanos era e malit». Mblo-dhi një krah me degë e fletë të thata ahu, që nuk i kishte zënë vesa dhe i lëshoi pranë dyshekëve. I la njëra mbi tjetrën, kërkoi në xhepa një letër, hodhi një grusht bar të thatë mbi të dhe i vuri shkrepësen. Degët e thata morrën zjarr me një kërcëllimë të thatë e të mbytur. Gjeti një letër tjetër të harruar në xhepa, e hodhi nën karthia dhe u ngut të mblidhte të tjera. Mirazhet e flakëve dri-dheshin në ajrin e ftohtë e të lagësht të mesnatës. Ai shqoi më mirë materialet në lëndinë dhe djalin që flinte. Një afsh i ngrohtë i rendi në kraharor. Bëri një «ah» kë-naqësie, shkopsiti xhakëtën dhe ra i përhumbar në dyshek.

Një zë i fryu lehtë në vesh.

«Çohu!».

— Plaku u drodh, hapi sytë përgjysmë dhe ktheu ko-kën ngadalë andej nga iu duk se e thërrisnin. Po askush nuk ishte. Vetëm era luante e përdridhej me fletët mbi bar. «Nuk fle, jo,— tha plaku me vete. — Rri shtrirë dhe ëndërrit».

Sonte ai s'kishte gjumë. Mos i thuaj moshës së tij të flerë, në s'do ta bësh armik. Tok me fërshëllimën e fletëve, iu duk se dalloj një lëvizje tjetër. U çua përgjysmë.

«Ç'të jetë? — mendoi dhe prapë i shkuan të ngje-thura. — Ndoshta rrëshqet uji nëpër bar».

Pa nga djali. Mbajti vesh.

«Të jetë burim, vallë?»

U ngrit dhe ngau këmbët nga vinin murmuritjet në ahishte. Murmuritjet u bënë më të kthjellëta. Bëri më tej. Këmbët i shkanë në bar. Një diçka e ftohtë, e lagësht i hyri në këpucë. U kthye pas dhe pa reflektimet e yjeve në bar, që ngjanin si gjuhëza flake. I ndoqi me sy deri lart, nën hijen e një ahu degëgjërë. Nën dritën e hënës, që

luhatej mes degëve, yjet vallëzonin në pasqyrën e pellgut. Mbështeti gjunjët në një vend të thatë e ngjiti buzët në cipën e tejdukshme.

Zjarri kishte filluar të mpihej. Mori një dorë shkarpa, i hodhi mbi të dhe flaka nisi prapë të merrte frymë. Djali gërhiste në një gjumë të thellë. Plaku e kishte harruar fare. Iu afrua shtratit portativ dhe e tundi.

— Ngrehu, se u bë zjarri.

Djali u ngrit ndenjtur dhe kapsalliti sytë. Nga pyjet në shpatet e malit avitej një zhurmë. Plaku mbajti vesh. Vërtet kishte lëvizje, zëra që trazonin heshtjen pas mesnate, këmborë e zile bagëtie. Tingujt e këmborëve, të lehurat e qenve u bënë më të shurdhëta; shushurimat e fletëve dhe murmuritjet e ujërave ndiheshin si më parë. «Uji është brisk, si nata vetë», — mendoi. Iu kujtua tufa e çajit që kishte futur në çantë. Ai kishte dashur të merrte akoma, por inxhinieri i kishte thënë se aty do të ishin mes çajit. Sheqeri ishte në arkë. I lindi një mendim. Mori tenxheren, gotën e ujit dhe shkoi në burim. Yjëzimet u drodhën në sipërfaqen e pellgut. Hodhi ca shkarpa të thata në prushin që po e vishte hiri, këputi tre shkopinj nga një ah i njomë, i lidhi me tel në anë dhe i nguli mbi zjarr.

— Ç'po bën kështu, o xhaxha? — foli djali.

— Pastaj do ta shikosh.

Djali u vu të mblidhte shkarpa. Kur u kthye, plaku kishte varur tenxheren në trekëndëshin e drunjtë. Nga ajo dilte avull. Shtëllungat e avullit, që luhateshin në ajër, sikur e shushatën plakun.

— Ç'mendon ashtu?

— Vitet, bir, vitet... Qëpari të fola rëndë, se ashtu m'u përgjigje, dhe mua nga mosha e lodhja më kishin zënë sytë perde. Tani më duket se edhe këtu kam shkelur: çdo pemë a gur më hedh në mendime.

Dhe i foli për partizanët Sulo e Tirkë, që ishin shtrirë njëherë pranë zjarrit. Të uritur e të rraskapitur i kishte marrë gjumi. Ushqime nuk kishin me vete. Mbushën një gavatë me ujë dhe e lanë mbi zjarr, që të ngroheshin sadopak e të mbushnin stomakun. E pinë me thërrimet e bukës që u kishin mbetur në xhepa, pastaj bënë një gjumë të shqetësuar, tërë ëndrra.

Një uturimë motori gjëmoi në luginë.

— Erdhën, erdhën, — thirri gjimnazisti dhe u lëshua teposhtë luginës, nga vinte zhurma.

Plaku u zgjua nga kujtimet që e fushin në një dremitje të këndshme dhe vuri veshin. Gulçima e motorit sa vinte bëhej më e qartë. Trazoi prushin nën tenxheren që valonte dhe kërkoi gotat në arkë.

— I Lekëëëë! O Lekëëë!

Boria u përgjigj nga poshtë. Siç dukej e kishin dëgjuar gjimnazistin. Rreshtoi gotat në lëndinë. Një, dy, tri...

«Kanë të ftohtë djemtë, — tha me vete. — Të kallkanos të ftohtët e mesnatës. Do të pinë një çaj që ta mbajnë mend!»

Shihte çajin që avullonte dhe kënaqej. Kënaqej si një njeri që i është futur një pune dhe i duket se nga duart e tij ka dalë diçka e madhe.

THYERJA E QIVURIT

Aliu i tha karrocierit të mos vonohej në pijetore dhe u fut në dyqan. Dy djemtë ndaluan të hutuar te pragu, duke kullotur vështrimin sa andej-këndeje. Si duket e humbën durimin nga heshtja e Aliut, se hynë dhe ata brenda. Dhoma ishte e gjerë, me tavan të ulët, ndarë me dy qilima të vjetër leckë, qepur me spango, në dy faqet e mureve dhe në tavan. Në pjesën e dukshme të dhomës, para së ndarës, ishte një tavolinë pune dhe ca prodhime dërrase, stivosur në një cep. Jo shumë larg këmbëve të tavolinës, mes një togu dërrasash ishte ulur një mesoburrë me flokë të thinjur, ngjyrë argjendi. Herë merrte çekatin, herë zdrugun, sqeparin a sharrën dhe mbërthen-te, zdrugonte a sharronte ato që kishte përpara dhe i ngrihte në tavolinë: kapakë sëndyqësh, mindere, kuadrate dritaresh. Buzëqeshte herë-herë, dhe nga kraharori i gufuar shpërthenin ca murmurima kënaqësie që, po ta shih-te ndokush që nuk e njihte të fshehtë e zanatit, do ta merrte për të çmendur. Djali i madh shkopsiti xhakaventon te fyti, po s'luajti nga vendi. Nuk i vinte mirë të prishte lumturinë që kishte kapërthyer flokëthinjurin. Rrudhat e tepërta të gdhendura në atë fytyrë të thatë e të mprehtë ngjanin me shtretet e përrenjve të tharë. Dukej që këto çaste në jetën e tij më se pesëdhjetëvjeçare kishin genë të pakta, ashtu si qielli i ngarkuar, i ftohtë i një dite dimri, që ka parë për pak kohë fytyrën e diellit.

Aliu kroi kokën mbi kapelen e dalëboje, u shkoi dorën mustaqeve të bardha dhe u mat t'i fliste, por ndjeu dorën e të birit në sup.

— Hë? — tundi kokën dhe i shkeli syrin.

— Prit edhe pak, — pëshpëriti djali me xhakavento bojë vaji.

Ndenjën ashtu derisa në tallashin si miell dhe nga buzët e thara, tërë plasa doli një fishkëllimë e gjatë në ulje. Mesoburri i thinjur nguli sqeparin në një trung ahu, fërkoj duart me një ndjenjë kënaqësie dhe hodhi sytë nga dera, që t'i çlodhte në atë pak qiell që dukej mes hapësirës së shtëpive karshi. Vështrimi i tij u mbërthye me atë të atyre të treve që rrinin në këmbë, pa guxuar të nxirrnin një fjalë. Zemra i rrahu fort, ndjenja e tregtarit i gëloi në damarë.

— Urdhëroni... urdhëroni! Sëndyqë, frona, mindere, ç't'ju dojë e bardha e zemrës. Uluni, uluni njëherë, të merrni frymë e ta dridhni njëherë, se ju ka lodhur udha, pastaj i shohim, ja tek janë, — tregoi me kokë në cep të dhomës. — Po ç'kemi nga fshati?

— Nuk jemi në fshat, — tha djali me xhakavento.

— Nejse, — kafshoi buzën flokëthinjuri për hamendjen e tij të gabuar. — Njëlloj u bënë tani. S'ka gjë, uluni, uluni! — dhe nxitoi t'u nxirrte një fron. Me atë plakun që kishte ardhur në mëngjes, mesoburri i thinjur, që e quanin Xhemal, e kishte kurdisur mirë hesapin. I kishte parë opingat e laturisura me baltë dhe nuk i kishte lënë kusur, pa e pyetur për farefisnin dhe fshatin. Plakun e bëri për vete mjeshtri gojëmbël që i kishte gjetur zemrën, zgjidhi qesen pa iu dridhur dora dhe, pa u grindur për pazarin, mori një sëndyk e tri mindere për dasmën e të birit. Kur u ndanë, u puthën e u përqaftuan, dhe plaku i premtoi se do të kthehej këtej patjetër kur të kishte të bënte me punë druri.

Xhemali ishte kënaqur me pazarin e plakut, por këta të tre, që rrinin në këmbë para tij, pa hapur gojë, nuk i pëlqyen. As ai burri me kapele të dalëboje, me mustaqe të bardha e këmbë të shkurtra, që në ecje rëndonte më tepër nga e djathta, as ai djali i parruar me xhakovento bojë vaji, as ai djali nja gjashtëmbëdhjetëvjeçar me këmishë të lerosur, lëshuar mbi pantallona, dhe me sandale të lidhura me spango. Përse ta lodhte mendjen, në ishin qytetarë e fshatarë? Nuhatja e tregtarit i dha të kuptonte se ishin «kallinj pa bukë», që futen dyqaneve për të kaluar kohën. Ata nuk shikonin sëndyqet e minderet, po rrinin në këmbë dhe s'ia ndanin sytë. Logjika e tregtarit i kishte mësuar se pritja e mirë i shton ustallëkut atë që kanë mangut duart dhe bën që pas derës të mos reshtin klientët e xhepi të mos zbrazet. Po me këta as që ia vlen-te. Vështrimi i tyre iu duk i ftohtë, fshihte diçka. Pa nga dera. Jashtë lëviznin njerëz. U mbush me frymë, i lehtësuar.

— Çfarë doni? — ua preu shkurt.

— Loni na ka dërguar, — tha djali i madh me xhakavento. — Të fillojmë punë bashkë.

— Aha, po, ju jeni? Të fillojmë, hë... — psherëtiu ai. Dyshimet e para sikur i qenë përndarë në kokë, po prapë kishte të tjera. Mori nga kutia e duhanit një cigare të dredhur qysh më parë dhe e vuri në buzë. Pas kësaj kutia u fsheh shpejt në xhepin e pantallonave, sikur të ishte në duart e një prestigjatori të çuditshëm.

Aliu tundi kokën, nxori të tijën dhe ua zgjati djemve.

— Karroca me materialet pret jashtë. Ta fusim brenda? — tha i madhi.

Xhemali heshti. Iu kujtua Loni, burri me qillota ushtarake e flokë të rrallë, të shkurtër, që i kishte ardhur pardje. Çirak te dyqani i Patriut kishte qenë ai, kishte qenë dhe partizan, po tani që krismat e pushkëve e të mi-

tralozave ndiheshin më rrallë në male nga bandat diversioniste, e meqë ishte plagosur dy herë në këmbë dhe s'bënte dot rrugë të gjata, si usta i drurit që ishte, e kishin ngarkuar të krijonte kooperativën. Për këtë punë kishte ardhur te Xhemali, po ky kishte mbledhur supet. Loni s'e kishte humbur durimin; me gjakftohtësi, i zgjodhi kuptimin e kësaj fjale. Një tjetër luftë, më e madhe se e para, zinte fill: ndërtimi i asaj që u rrënuar. Ashtu si dje luftuan bashkë, dhe sot do të punonin bashkë. Do të lidheshin këpucarët, rrobaqepësit, teneqepunuesit, marangozët në të parin bashkim, në të parën kooperativë.

— Ti ke pasur dyqan te Radaneci, — i tha Xhemali Aliut.

Tjetri tundi kokën në shenjë pohimi.

— Pse të mos bëhet dhe jotja koo... si i thonë, more, e bashkuar.

— Në atë pëllëmbë vend nuk arrin dot të bësh një qymez pulash dhe jo të hapësh dyqan, — tha djali i madh. — Ajo është gjermadhë, të shpojnë mishrat nga igrasia. Do të prishet gjithë ai pellg dhe do të ngrihen binara të reja.

— Kush do t'i ngrejë?

— Shteti që erdhi në fuqi.

— Po ti ku e ke pasur dyqanin?

— Te Radaneci, ti e di. Pastaj dola malit. Ky është babai im. Mua më quajnë Fiqiri.

— Po tjetri?

— Ai ka qenë ilustraxhi. Prindët iu vranë në një bombardim. Tani rri me xhaxhanë. Ndreko ia thonë emrin.

— Dhe do të bëhet marangoz?

— Pse të mos bëhet? I ri është, i zgjuar, e thith me njëherë çdo gjë që t'i thuash.

Xhemalit i kërcyen damarët në tëmthat e zbardhur. Ankthi që e kishte pushtuar atë ditë kur erdhi Loni, e

mbërtheu përsëri. Ata të dy kishin ardhur të fushin këmbët në dyqanin e tij, i kishin sjellë edhe një fëmijë që s'kishte hapur sytë mirë, për t'i dhënë ai zanatin. Pale, kishin gjetur dhe kohën! Këmbët po e linin, fuqitë po i shteronin, ndonëse vitet nuk kishin ecur aq revan, sa fizionomia e tij e plakur. Pastaj do t'i tregonin derën. Dinte ai çfarë përgjigjeje të jepte, po ç'të bënte! Ia kishte dhënë fjalën Lonit. Nuk ishte keq ashtu si kishte thënë ai, dhe Xhemalit i qe mbushur mendja, por...

— Edhe ky imi nuk është i madh. Mezi fusim kokën të gjithë ne dhe jo më të punojmë, — tha, i zënë ngushtë.

— Po të hiqet qilimi, hapet goxha vend.

— Po unë ku të fle? — mori zjarr Xhemali. — Të punojmë në bashkimin e Lonit dhe, për të fjetur, të zëmë rrugët...

Aliu dhe djali i vogël nuk folën. Fiqiriu u hoq mënjane të dridhte një duhan me duart që i dridheshin nga nervozizmi. Ndërkaq filloi t'i shpjegonte se dyqani nuk do të bëhej pronë e Lonit, por e të gjithëve. Xhemali nuk kishte ndihmuar si të tjerët Lëvizjen Nacionalçlirimtare, po as kishte ngritur zërin kundër saj. Ishte mbledhur e struktur në dyqanin e vet.

Ai fliste... Xhemalit i bëhej sikur kishte Lonin para syve, dëgjonte tingëllimën e zërit të tij dhe heshte. «Ta ketë shok Loni këtë?», — mendonte. Kjo heshtje, pas një bisede të gjatë, tregonte se fijet e dyshimit kishin filluar të shthureshin. Ai jepte të vendoste, po nuk shprehej dot. Një si kotkë i ishte mbledhur në fyt. Heshtja do të kishte zgjatur edhe më, po të mos kishte hyrë karrocieri tërë nerva.

— E po nuk pritet më, de, ta marrë djalli, ta marrë! Më thoni ulu në pijetore! Sa të pish kafen, ne e mbarojmë punën dhe... ia shtroni muhabetit. Do t'i shkarkoni,

apo t'i shkarkoj vetë?! Ç't'i bëj Lonit që s'po vjen, pa e dija unë!..

— E pse të vijë? — tha Fiqiriu. — Nuk jemi të zotë ne të fusim pesë para mall brenda! Loni edhe pa këto, ka shumë punë. T'i fusim apo jo, Xhemal, si thua?

Xhemali nuk tha as po, as jo, po tundi kokën në she-një pohimi. Në shpirt iu derdh po ai trishtim, po ajo zbra-zësi që e kishte bërë të sajën prej dhjetë vjetësh, qysh kur e ndjera nënë e tij mori frymë për herë të fundit. Në shtëpinë e tij, që i ngjante një varri, ai zvarisej mbrëmje-ve si hije, dhe në mëngjes, sapo zbardhte, si hije rrëshqiste që aty, duke lënë pas kumbimin e hapave të shurdhët në dhomën e vogël e të ngrohtë. Çdo natë kthehej në pije-tore, mbushte një faqore me raki kumbulle dy herë të zjerë dhe e thithte në vetmi. Shtrati i nënës, mblesëria e pambaruar, vështrimet gjithë mëshirë të të njohurve, që sikur i thoshnin: «Ah, i mjeri ti, qyqari ti...»

Nuk kaloi shumë kohë, dhe shiti shtëpinë e rrobat. Mbajti teshat e veta, shtratin prej dërrase, qilimat e vje-tër prej lecke, që i shërbenin si mur dhomës së gjumit në dyqan. Mblesëria ngeli në hapat që la e mjera nënë. Atë e mbuloi pluhuri i kohës, dhe atij i qe mbushur mendja se njeriu mund ta kalojë jetën edhe beqar, mund t'ia dilte edhe vetëm me forcën e krahëve të tij. Dhe ia kishte dalë, duke lënë mënjanë grindjet e vogla me kolegët e vet për klientët e rinj. Po Loni pardje i kishte futur ca mendime të tjera. E djeshmja, e sotmja, e ardhshmja vërtiteshin në trurin e tij të shqetësuar. Mbi komodinë kishte mbetur faqorja me rakinë e pardjeshme, gjë e rrallë për të. Gojën e kishte helm, i bëhej se kishte pirë aq shumë, sa për tërë jetën s'kishte më nevojë.

— Do ta gjejmë një dhomë, — tha Fiqiriu, vetull-ngrysur. — Nuk jetohet kështu, jo. Edhe kafshët gjetkë punojnë, gjetkë prehen.

Kështu i kishte thënë dhe Loni.

— T'i fusim atëherë?

Xhemali nuk foli. Shkoi te karroca, kapi një dërrasë, por, meqenëse nuk mund ta mbante vetë e nuk donte të thërriste njeri, e la prapë dhe mori një arkë me gozhdë. Fiqiriu buzëqeshi, kapi dërrasën aty ku ende ishin gjurmët e gishtërinjve të Xhemalit, i thirri Ndrekos, e ngritën të dy peshë dhe ecën pas hapave të tij.

* * *

Ata ikën vonë. I thanë të vinte me ta, po ai nuk pranoi. Ndihej i lodhur, i këputur. U shtri në krevat dhe hera-herës lëvizte perden e qilimit. Dërrasat e mbledhura tok, arkat e gozhdëve e të materialeve të tjera, tavolinat e posafilluara e bënë të zgjaste kokën. Era e pishës dhe e ahut i guduliste hundët dhe e bënte të rënkonte thellë.

«Kur të kesh të tillë material, na bëj zë», — i kishin thënë klientët e vjetër.

Dhe ja tani kishte dërrasë dhe dëshirë për të punuar. Po a mund të bënte gjë, pa biseduar me ta? Nuk ishte e tija kjo, ishte e të gjithëve. Por do t'ua thoshte «ortakëve» një herë. Përshtypjet e para për ta nuk ishin të këqija. Kur dërrasat ishin futur në dyqan, ata nuk e kishin parë më mjeshtrin në sy, po i qenë përveshur punës. . .

— Fillojmë? — pyeti Fiqiriu.

Xhemali pohoi me kokë.

Ai hoqi xhakaventon dhe nga këmisha me vija, tërë erna i dilnin krahët muskulozë. Ndrekoja rrinte pas tij. Një gozhdë nguli i madhi në dërrasë, dhe Xhemali nuk ia pa më krahun. Të tjerat i mori i vogli. U shtrembëruan të parat, dhe Xhemalit i çëriti në zemër.

— Ja kështu, — thoshte Fiqiriu.

Merrte çekanin, provonte dhe ia jepte përsëri. Së fundi gozhdët e gjetën rrugën në tulin e dërrasës. Ato ngjanin si qëndisma njëngjyrëshe të një xhamadani në sfondin e bardhë të drurit.

«S'ma kanë nevojën, jo», — mendoi Xhemali.

— Po unë ç'do të bëj? — pyeti ai.

— Shkoni me babanë te Loni dhe kërkoni ndonjë gjë tjetër të nevojshme.

Ai shkoi me çalamanin. Loni nuk ishte në zyrë.

Ndaj të ngrysur ikën. Xhemali u fut në të ndarën e tij. Çdo gjë ishte në vendin e saj të mëparshëm. Mbi komodinë një letër e mbështjellë. E hapi. Një piperkë turshi. «E paskan lënë, s'e kanë marrë», — qeshi me vete. Mori faqoren dhe hoqi dy gllënjka. Helm iu duk në fillim, po kafshoi piperkën dhe sikur i shijoi. Hoqi prapë, u shtri dhe nguli sytë në tavan.

Dhe ashtu e zuri gjumi.

* * *

Të pasnesërmen Loni erdhi e i pa.

— Sot do të mbartesh, — i tha Loni Xhemalit.

— Sa mirë! — tha Ndrekoja.

— Ku kështu? — e pyeti Xhemali.

— Te Kalo Kaçi.

— Si, me të? — u çudit Xhemali.

— Pse, ç'është ai, mbret?

— Në mos mbret, tregtar.

— Ishte, tani s'është më.

— Pupu, sa dhoma ka ai! — tha Aliu. — Mund të futet gjithë qyteti brenda, e prapë të ketë vend.

«Eh, Kalo, Kalo! — murmuriti Xhemali. — Më thirre dje të të rregulloja kotecin e pulave e t'u tha goja të më

thoshe: «Hajde brenda». Edhe rakinë ma nxore te shkallët, se të ndoteshin qilimat me rrotë. Ç'do të thuash tani që do të vij si komshi?»

— Kur do t'i çojmë?

— Kur të doni, rregulloni njëherë vendet e punës.

«Mos do të tallesh me pajën time, o Kalo? Mos do të më gjellavitësh nëpër lagje? — mendoj Xhemali dhe ndjeu një afsh të nxehtë t'i digjte trupin. — Një këndes me plaçka solli, do të thuash. . .»

— Vallë do ai? — foli përsëri i shqetësuar.

— Akoma me këtë ti, do ai apo nuk do? — tha Loni e qeshi. — Karrocën hajdeni ta merrni kur t'ju duhet.

— Kështu e lëmë, — u përgjigj Fiqiriu.

— Mirë, atëherë. Ditën e mirë e me krahë të lehtë! Dhe ikën. Ata vazhduan punën.

* * *

— Karrocieri nuk erdhi? — pyeti Xhemali.

— Jo, kishte shumë qejf të yinte, po i doli një dasmë në fshat. Kur të rregullohesh në shtëpinë e re, do vijë të të urojë. Kështu i kishte thënë rojës së ndërmarrjes. Hajde, tani, lëre punën, se mbaroi tetorëshi.

— Ç'është ky tetorësh?

— Kaq do të punojmë në ditë, — tha Fiqiriu. — Duhet të çlodhemi pas pune. — Për pak sa nuk i tha: «Duhet të rendim të gjejmë ndonjë zogëzë, se po na kalon koha», po iu kujtua mblesëria e papërfunduar e Xhemalit, që ua kishte zënë në gojë para ca ditësh. Pastaj shkoi te qilimi, kapi telin, e solli rrotull gozhdës disa herë, sa u këput, mori qilimin në krahë dhe e hodhi në karrocë.

Xhemali u çua dhe i vuri pëllëmbën në sup, si t'u thoshte të mos vazhdonin.

— Do ta bëjmë ne të dy me Fiqiriun këtë punë. Mos u merakos ti, usta Xhemali, — tha Ndrekoja. — Dridh një duhan me xha Aliun dhe rri rahat.

Xhemali erdhi rrotull dhomës, pa ditur se ç'të merrte. Të treve u bëri përshtypje tronditja e tij. Vrazhdësinë e jetës flokëthinjuri e harronte sa herë që futej pas qiliimit të vjetër. Kthina ishte ngulur si gozhdë në jetën e tij, dhe tani që po e shkulinin që aty, ndiente dhembje.

Djemve u kishte vesuar balli, po nuk dinin të pushonin. Një fjalë s'kishte bërë me ta, ashtu si kishte kujtuar në fillim. Dhe ata s'i kishin dhënë rast, vetëm punonin. Sqeparin e zdrugun nuk i përdornin keq, sidomos ai djali me xhakavento s'ia kishte nevojën në zanat. Dhe tjetri po e merrte veten.

«Edhe kafshët gjetkë punojnë, gjetkë flenë», — i kishte thënë Loni.

Mos e kishin fyer? Në zërin e tij nuk kishte pasur pikë ironie e talljeje. Mos që bërë kafshë vërtet? Njeriu, kur zhytet në një batak, sado i ndyrë që të jetë, nuk e sheh qelbësirllëkun, se i janë veshur sytë, nuk e nuhat dot erën e keqe, se e ka zënë rrufa.

— Dyshekun ta shkundim, — tha Ndrekoja.

— Lëre, lëre, mirë është!

— Si ta lëmë? Ai ka një okë pluhur. Shkunde, ore, shkunde!

Fiqiriu e la dyshekun te pragu, mori një shkop dhe i ra me tërsëllëmë. Re pluhuri u ngjitën lart. Kalimtarët pranë dyqanit shanë me zë dhe ia dhanë vrapit. Një plakë zgjati kokën nga dritarja karshi, zbrazti fjalorin e saj dhe e mbylli kanatin aq fort, sa u drodhën xhamat.

— Mbaruan, kaq janë, — tha Xhemali.

— Ka vend akorna në karrocë, — tha Fiqiriu.

— Ka vend, po me se ta mbushim, pa...

— Shkojmë atëherë. Ndrekoja do t'i mbajë sipër. Ti, usta, me plakun tim prisni në pijetore sa t'i rregullojmë ne plaçkat.

— E kushedi sa ka për të rregulluar, — foli Xhemali.
— Ashtu e lëmë atëherë. Në pijetore.

Ashtu kot tha për pijetoren, se dhe aty nuk ia kishte enda të shkonte. Do ta shikonin me habi kur të ulej në tavolinë. Duhet të kishte mbajtur ca rroba atëherë, të mos i kishte rënë me top... Po kjo ishte bërë e nuk kthehej më. Tani i mbetej të dëgjonte fjalët e thashethemet e plakave në sofate e pas portave, ironinë e tregtarit Kalo, kur të ndalej te dera.

«Po bagazhet e tjera kur do të vijnë?» — mund t'i gërvishte nervat zëri i tij.

«Bagazhet e satëme!...»

Për shokët e punës nuk i bëhej vonë, se ua kishte zbrazur zemrën e, edhe ata, të «rrogosit» ishin, s'ishin nga ata që të mbanin në gojë; po ajo fytyra e bardhë, e hequr, nën borsalinë do të shikonte të katër muret dhe do të ngërdheshej. Xhemali do të zjente nga inati, se kohët e fundit që bërë nevrík dhe nuk e kishte për pesë të ta jepte një shuplakë, po ta fyeje. Duke e ndier këtë dobësi, ai bënte një sy qorr e një vesh shurdh.

* * *

Ata që ishin ulur në tavolina, mes shtëllungave të hirta të tymit të duhanit, bënë me të vërtetë një «oh» habie. Nuk mbahej mend prej sa kohësh Xhemali nuk ishte ulur në tavolinë, s'kishte rrëkëllyer një gotë e s'kishte këmbyer ndonjë bisedë me njeri. Mbahej mend vetëm fraza e përmortshme: «Mirëmbërëmani, si u ngryset?», shishja e rakisë që rrasesh në xhepin e xhakëtës së

grisur të kadifenjtë, kurrizi i tij i thyer që dilte prej dere. Xhemali e vuri re habinë, po nuk i erdhi rëndë. «Kjo s'është gjë para ngërdheshjeve të Kalos», — mendoi. Këpucari Gaqo i dërgoi një dopio në tavolinë, e toku me të nga larg dhe e uroi. «Me krahë të lehtë!» Dhe ai kish-te hyrë në bashkim. Rakia e dytë nuk kishte ardhur akoma, kur ai nuk i ndjeu më vështrimet e tavolinave ta shponin si me gjilpërë.

— Çudi, more, si erdhën këto kohë!.. Të punuarit bashkë ka një të mirë, se thyhet kjo e shkretë mërzi, — e hapi bisedën Xhemali.

— Nuk bëhej ndryshe, jo. Të tjera rregulla erdhën. Edhe për të mësuar, mëson nga njëri-tjetri. Kështu thotë im bir, — ia ktheu Aliu tërë qejf.

— Këtu më qëndro. More Ali, si t'ia marrin dorën zanatit, — le që atij tëndit nuk i trembet syri, — më ha merakun mos na hedhin si limonj të shtrydhur.

— Kush të na hedhë, more? Ne punojmë për veten tonë, jemi ne në fuqi! Kështu më ka thënë im bir.

Xhemali u koll, i ndritën sytë dhe pohoi në heshtje. Si kaloi nja një orë, u kthyen dhe djemtë.

Të hutuar, ata iu afruan tavolinës, po nuk vendosnin të uleshin. Pleqve u ishin skuqur sytë, u ishte trubulluar mendja dhe nuk e vunë re shqetësimin e djemve.

— E, de, thuaja! — tha Fiqiriu.

Ndrekoja mblodhi supet.

— Mbaruat, djema? E keni hak një gotë, — foli Xhemali çakërcejf.

— Dale, usta. . .

— Çfarë?

— Kur shpinim rrobat, Ndrekos ia mori mendjen një çupë dhe na përmbysi karrocën. Plaçkat ranë dhe, kur i ngritëm, gjetëm një zarf në kalldrëm. Kishte një letër në të dhe të holla. Mblodhëm sa mundëm nën flakën e shkretë-

pëses, po nuk e dimë sa ishin të gjitha. Ndrekoja ka hall mos kanë mbetur akoma në kalldrëm. Po të ketë akoma, do që të shkojë prapë, të flerë sonte aty. Ka frikë mos ti, usta, e quan hajdut.

— Ç'është ajo, more! — u hodh Xhemali i trubulluar. — Unë ju njoh tani dhe e di që s'jeni nga ata. Nëma zarfin dhe harrojeni. Çfarë do të pini, raki?

Fiqiriu pranoi, Ndrekoja kërkoi kafe.

Xhemali piu një dopio, kërkoi dhe një tjetër, po letra në zarf nuk i dilte nga mendja. «Ta kenë lexuar vallë? — mendoj. — Kushedi, më quajnë të marrë...»

Te jastëku ishte ajo letër. Çdo ditë e shihte më parë. Kishte mbetur pa të holla në stinën e dimrit, me një kothere bukë e kishte shtyrë urinë, po zarfin nuk e kishte hapur. Ai mbartte një moment të trishtuar për jetën e tij.

Hoqi një gllënjë, po nuk i rrihej.

— Do të dal, — tha.

— Ngrihemi të gjithë, — foli Aliu.

— Jo, jo, nuk vonohem. Do të vij prapë.

U çua nga tavolina. Banakieri, shishet në rafte, fytyrat e skuqura nga pija, tavolinat, muret, llamba që varej në tavan, iu bë sikur iu rrotulluan para syve. Koka i dukej e rëndë, hapat të pasigurt.

— Mbahu, Xhemal, mbahu! — dëgjoi një zë pas shpine, po nuk e ktheu kokën. Eci mes tymit të tavolinave dhe doli.

Ata nuk lëvizën.

— Përse shkoi? — tha Fiqiriu.

— Ndoshta zarfi... .

— E mbërtheu rakia. E çuditshme është. Po e lage gurmazin, të lënë hallet që të kanë rënë mbi kokë. Kur ajo e shkretë të lëshon në mëngjes, ato bëhen prapë edhe një herë më të mëdha se ç'ishin, dhe duhet të pish prapë që

t'i harrosh paskëtaj. Shko pas tij, shko, — tha Aliu. — Kushedi çfarë i ra ndër mend.

Fiqiriu bëri si i thanë. Në tavolinë ra heshtja.

* * *

Qepeni u ngrit me një gërvishje të zgjatur. Çelësi u rrotullua në derë dhe ajo u hap me një kërcitje të thatë. Ai hyri në terrin e dyqanit duke u lëkundur. Fiqiriu, që e kishte ndjekur në çdo hap, nuk pa gjë tjetër, përveç errësirës. Pastaj vezulloi një dritë e dobët, dhe ai shqoi siluetën e kërrusur të Xhemalit, rënë mbi tavolinë. Pastaj Xhemali ngriti kokën me përtesë, hodhi sytë rreth e qark e murmuriti, si të kishte njeri pranë.

— Qenkësh goxhà vend. Si s'ma kishte zënë syri më parë?

Katër bangat e punës ishin vënë në katër cepat e dhomës. Në mes të dyqanit mbetej prapë shumë vend. Ndenji i menduar pranë bangës së tij, e lëmoi me pëllëmbën e madhe, si të ledhatonte një fëmijë, pastaj seç i erdhi ndër mend dhe futi dorën në xhep.

«Te paratë e ka hallin, — mendoi Fiqiriu. — Do të shohë që janë mangut dhe do t'i zbrazet Ndrekos».

Xhemali nxori tufën e të hollave dhe i rrsi në xhep, mori letrën, e shpalosi me duart që i dridheshin dhe uli sytë mbi të. Fytyra iu bë më e vrenjtur. Papritmas e zhubrosi dhe e hodhi në dysheme, pastaj si duket u pendua, e mori prapë dhe e hapi mbi flakën e kandilit. Ajo u dogj e tëra dhe në vend të saj mbeti një grumbull hiri. Luajti tavolinën e tij dhe ngriti një dërrasë nga dyshemeja. Fiqiriu e pa të merrte kandilin e të futej i tëri në hapësirën e bodrumit, ku ishte hequr dërrasa. Në dyqan ra prapë errësira. Pas pak kohe iu afrua gojës së bodrumit. Një

zhurmë e mbytur e një rënkim. Fiqiriu, që ishte pas derës, kujtoi se ai qe penguar e qe vrarë keq, dhe u afrua te hyrja e bodrumit.

«Ç'kërkon vallë?» — mendoi.

Një trup i zi mbushi gojën e bodrumit e doli jashtë si një gjuhë e stërmadhe e një kafshe parahistorike. Xhemali e shtynte me gjithë fuqinë dhe rënkonte herë pas here. Fiqiriu e kapi në pjesën e sipërme, që ta ndihmonte. Trupi që doli nuk ishte gjë tjetër, veçse një arkë e madhe, mbi të cilën ishte vendosur një beze e zezë.

«Qenka qivur, — mendoi djali e mornica i shkuan në trup. — Të ketë vrarë njeri, thua?».

Në të vërtetë arka e mbështjellë me bezen e zezë ishte e rëndë. Fundi i qivurit doli nga bodrumi, dhe Fiqiriu, duke e tërhequr zvarë, e la në dysheme, jo shumë larg hyrjes së bodrumit. Nga vrima e bodrumit u lëshua në dhomë drita e kandilit dhe u shfaq silueta e Xhemalit.

— Kush je ti?

— Unë, Fiqiriu.

— E dija që do të vije.

— Si të të lija vetëm? Ti je trubulluar nga rakia.

— Hë, se s'ka gjë. Jam mësuar unë me të...

Fiqiriu vuri re që Xhemali nuk u shqetësua fare që e kapën me diçka të pazakontë. Po përsëri mendimi i ndo një njolle të vjetër nuk e la të qetë. Kurse tjetri s'po e prishte terezinë. Drodhi një duhan, i zgjati një dhe atij, pastaj e thithi fort me të gjithë mushkërinë, i dha kandilin ta mbante, ngriti qivurin dhe e la mbi tavolinë.

— Ka dhjetë vjet që e pastroj përditë, — tha, — që, kur të më rrëmbente mortja, të kishin ku të më kallnin.

— E ku ta dinin ata ku ishte futur ai? — pyeti djali.

— Do të kërkonin në dhomë, nën jastëk do të gjenin letrën që gjetët ju, të hollat, qivurin, rrobat e vdek-

jes. Do ta lija në një vend që ta shikonin kur të më afroheshin.

Hapi kapakun. Fiqiriu afroi dritën dhe shqoi një kostum të zi, një këmishë, një kollare dhe një palë çorape dhe mendoj se këtë zakon e kishte parë edhe te babai, nëna e kushërinjtë e tij, po s'u kishte folur kurrë.

— Të bëhet nganjëherë e mërzitshme jeta, o bir, dhe roit e nuk di ç'bën. E prita sa e prita të mallëkuarën vdekje të vijë, po ajo s'u duk. . . — tha Xhemali. — Nuk vjen tashti, jo. Më erdhët ju dhe nuk e lini të bëjë çap.

Nuk priti përgjigje, kërkoi me tahmin sqeparin në gjysmerrësirë dhe e gjeti. U mëshoi fort dërrasave të veshura me beze të zezë. Çdo goditje e shoqëronte një sharje që dukej si rënkim .

— Po vjen dimri, biro, duhet bërë zahireja e druve.

Fiqiriut i pëlqeu humori i Xhemalit. Ishte hera e parë që ai bënte shaka gjatë këtyre tri ditëve. Vërtet u kishte ndenjtur pranë, po për të folur, fliste rrallë.

Dërrasat humbën formën e qivurit. Ai hodhi sqeparin dhe hoqi xhaketën. Fiqiriu i shihte trupin e vogël, lakuriq në gjysmerrësirë. Pastaj e pa të vishte kostumin.

— Me shëndet, o usta Xhemali!

Dhjetë vjet më të ri e bënin ato.

— Shëndet paç gjithmonë, o bir! Nesër është e diel. Do të shkojmë prapë në pijetore. Të vemi si njerëz.

Nxori kutinë e duhanit, po e futi përsëri.

— Ata po presin. Duhet të shkojmë, se mërziten. I kam dhe Gaço këpucarit një qerasje.

Doli pa iu marrë këmbët. Fiqiriu mbylli derën, uli qepenin dhe i hodhi krahun. Ai kundërshtoi.

— Më lër, më lër të bares vetë. Sonte, sado të kem pirë, prapë jam esëll.

Dhe ecën më tej.

Ishte një natë e bukur, e butë, me hënë.

VULLNETARËT

Pesë vetë ishin: tre djem e dy vajza. Djemve sa u kishin dirsur mustaqet në shtegun e buzës së sipërme, vajzave u ishte gufuar kraharori dhe u kishin shpërthyer gjinjtë si kokrra mollë. Në fshat ishte folur që do të vinin vullnetarë. Këtë ua kishte thënë vetë sekretari i komitetit të partisë të rrethit, në mbledhjen e gjerë me popullin, me rastin e krijimit të kooperativës. Para ndonjë muaji kishin ardhur punëtorë nga qyteti për të parë terrenin dhe u kishin thënë se fshati i tyre ishte i fundit që elektrifikohej, ndaj duhej të lëviznin më tepër. Uzina e tyre, që i kishte në patronazh, nuk do t'ua kursente ndihmën.

Dhe ja, vullnetarët kishin ecur nja tri orë të mira nga rruga automobilistike, nëpër rripat e ngushtë që zgjateshin e humbisnin kurrizeve të gjelbëruara të maleve, mes vreshtash, dhe kishin qëndruar te burimi në mes të fshatit. Djersa u sumbullonte në ballë dhe mollëzat e faqeve u ishin skuqur. Ladi, një djalë i gjatë me bluzë marinari, ftohu damarët te çurgu që dilte nga gurët dhe shkoi në zyrat e kryesisë. Aty nuk kishte njeri. Kryetari i kooperativës ishte në mbledhje në qytet, sekretari i partisë kishte shkuar në fshatin përtej vargut të maleve. Këto ia tha Fatoja, një vajzë e re, topolake, që mbante ca shkresa në duar. Pastaj ajo i thirri një fëmije që luante aty pranë e seç i tha në vesh. Fëmija tundi kokën i këna-

qur për atë që iu besua, dhe ia mori me të katra përtej zyrave.

Ishte mesditë. Dielli digjte e përvëlonte si saç. Ata lanë rrobat nën një pjergull që zvargej në muret e një shtëpie, dhe u ulën në hijen e saj, në një lëndinë të pjerrët. Ishin lodhur, vërtet, se dielli nuk u qe ndarë tërë rrugës dhe i kishte trallisur. Në atë kohë, udhëve të fshatit, lëvizjet ishin të pakta, po fëmijët se nga e morën vesh dhe u mblodhën një nga një, si t'i kishte thirrur njeri. E futën në mes Nevruzin fytyrëgjërë, me ata flokët e lëpirë, që ishte shtrirë në lëndinë e mbante fisarmonikën pranë, dhe nuk e lanë rehat.

— Bjeri njëherë, bjeri!

Atij sikur iu rënd në fillim, po kur ia kërkuan dhe vajzat, u çua, mori fisarmonikën në pëqi dhe u mëshoi fort gishtërinjve në tastierë. Kaq deshën këta që të shpilheshin. Kënga ndoqi këngën, dhe ai e ngriti zërin më shumë se fëmijët. Nga dyert e shtëpive plakat nxirrnin kokën, kureshtare, fëmijët rendnin nga pjergulla...

Do të kishte zgjatur edhe më kjo punë, po të mos kishte ardhur anëtari i kryesisë, Seloja, një burrë i shtyrë në moshë, me kapele kashte në kokë. Ai fshiu pëllëmbët e pluhurosura pas kofshëve dhe u dha dorën një për një. Pastaj ata lanë rrobat në shtëpinë e Fatos dhe morën poshtë për te luadhet. Një hop Fatoja i ndoqi pas.

— Ju do të vini tek unë, — i tha Dianës, një ezme-reje me buzë të trasha, veshur me një fustan basme me trëndafila të kuq.

Ajo i hodhi krahun në qafë e qeshi.

— Të shohim njëherë. Ne jemi bashkë.

— Epo në mbrëmje s'do të rrini me ta...

— Edhe me ta mund të rrimë, ç'të keqe ka në këtë mes? Janë vëllezërit tanë, — foli Diana dhe e pa drejt në sy.

Faton e hutoi vështrimi i saj. Sidoqoftë mundi t'i thoshte:

— Do të vish sonte, hë?

Diana tundi kokën e buzëqeshi.

Ashtu grup e duke bërë muhabet, vullnetarët i ranë fshatit mes për mes. Ai ndodhej në këmbë të një vargmali, i mbrojtur nga erërat, nën ca suka tërë vreshta. Përfund tij hapej një luginë e gjerë me dhë të butë. Ujërat e përrenjve, që derdheshin nga brinjët e maleve, futeshin në një lumë të qetë, që shkiste pa zhurmë në luginë. Në juglindje ishte një grykë e thellë, dredharake, që e mbante vrapin në qytet. Shtëpitë ishin të vogla, njëkatëshe, të lyera me gëlqere nga jashtë e të mbuluara me plloça, mes kopshtesh rrethuar me gardhe purtekash, ku skuqnin mollët e zverdhnin dardhët.

— Fshat i bukur! — tha Diana.

— Është larg.

— Përse të kenë ardhur njerëzit gjer këtu?

— Njerëzit janë si bletët, — u hodh e tha Seloja. — Aty ku gjejnë polenin, ulen e bëjnë kosheren. Toka këtu është flori. Po e punove, të nxjerr faqebardhë.

— Po përse kaq larg?

— Këtu s'bën dimër, — vazhdoi Seloja, — nuk pri-shen vreshtat e u ecën të lashtave. Ra dëborë para tre vjetësh, dhe njerëzit sa s'u çmendën nga gëzimi, po doli një diell dhe naaa e bëri, — dhe hapi pëllëmbën e fryu sipër.

Kaluan buzë përroit, në udhishten që të nxirrte për-pjetë fshatit, në sqepin e një kodrine ku rrëzohej një ka-tarakt shkumëbardhë. Disa këmbë lart vijës së ujit, një shtrat i thellë përroi dhe më tej një shtëpi gati e rrënuar. Seloja u tha se kishte qenë mulli, po kishte vjete që ai s'kishte bluar kokërr gruri. Dukej që njerëzit s'ishin me-rakosur për këtë gërmadhë. Ferrat kishin zënë hyrjen,

vende-vende çatia ishte e zbuluar dhe bënte t'i dukeshin trarët e kalbur nga shiu dhe era. Vera bëri në një udhishte tjetër, hipi në shkëmb dhe ua bëri me dorë. U ngjitën dhe ata. Që aty dukej mirë një shpat mali që fshatarët e quanin «Shpati i lugatit». Në këmbë të tij ishte një shtëpi e vetmuar dykatëshe, me dritare të vogla me hekura.

— Ndryshe nga të tjerat kjo, — tha Diana. — Shkojmë ta shohim.

Seloja u përtyp, u tha se s'kishin kohë, duhej të zbrisnin poshtë. Kryetari duhej të kishte ardhur, dhe duhej të vendoseshin në baza.

Një vello e lehtë, si më hi, po ulej në luginë. Mbi qafë ndiheshin blegërima dhensh, tinguj zilesh e këmborësh. Kopeja po zbriste në fshat.

Kryetarin e takuan në lëmë. Biseduan një copë herë për uzinën, elektrifikimin, të lashtat, që këtij viti ishin më të mbara, dhe pastaj i ndanë në baza.

Kur u err, s'kishte njeri në fshat të mos dinte për vullnetarët. Ata do të sillnin dritat si në qytet.

Vullnetarët ndenjën akoma te sheshi para zyrave të kryesisë dhe ia morën këngës. Me ta erdhën të rinj e të reja. Një plakë me shami të zezë në kokë kapi për mënge një vajzë flokëverdhë.

— Lëre, nëno, të këndoje me ne.

— U err, moj bijë. Kush do t'ia bëjë pajën?

— E çfarë paje, moj nënë! — u hodh Vera. — Ai që do ta marrë, do të dojë atë, jo pajën e saj.

Plaka nduku faqet, seç murmuriti me vete dhe vuri vajzën përpara.

Dianës nuk i hiqej nga mendja shtëpia dykatëshe te shpati i malit, dritaret e vogla me hekura. Fytyra e sëkëlldisur e Selos, hutimi i tij e shtynin edhe më tepër

kureshtjen e saj të kapërthehej me përfytyrimet e nxitura nga librat që mbartnin në vetvete të fshehta.

Si u nda me shokët, me Faton në një anë dhe Verën në anën tjetër, u ngjit udhëve të ngushta ndanë kopshteve të rënduara nga mollët, aroma e të cilave përzihej me atë të plehut që avullonte nga plevicat.

— U vonuat shumë, — tha Fatoja.

— Shkuam te burimi. Seloja na preu një bostan. Pas-taj hipëm te shkëmbi mbi mulli. Sa i bukur duket fshati që andej!

— Dhe nga shkuat?

— Tatëpjetë, pse?... Uh, vërtet, ç'ishte ajo shtëpi e vetmuar aty?

— Shtëpia e mallëkuar, — foli Fatoja dhe i shtrëngoi dorën, si të kërkonte të mbahej se mos binte.

— Kush e ka mallëkuar? — qeshi Diana.

Fatoja pa rreth e rrotull mos lëvizte kush dhe, si iu mbush mendja që s'kishte njeri, mori frymë thellë.

— Nuk është për të qeshur, jo, — filloi ajo. — Ka vite që aty nuk shkon njeri, qëkur iku mullixhiu i fundit i Merajve. Pleqtë tregojnë se Rakipi i Merajve ishte atëherë. Për punë takse e fajdeje u pleks me hoxhën dhe për pak sa nuk u ther me të. U zu, po çfarë të zënë! As që i trembej syri Rakipit. I dridhej buza e mjekra hoxhës, si ta kishin zënë dyzet palë ethe, i merrej goja, si të ishte gagaç, e s'lidhte dot dy fjalë. Po mendja i punonte sahat; duhej t'ia paguante atij që i kishte marrë erzin faqe njerëzve. Një kafshatë s'vuri në gojë atë natë, nuk i mbylli sytë që i mjegulloheshin nga pleqëria, po e gdhiu mbi kuran. I këndoi gjëmën Rakipit të Merajve, por edhe për vete s'pati ndonjë të mirë. Të pasnesërmen e kallën në varr, po, kur errej, ai dilte prapë dhe nuk i ndahej asaj shtëpie. Me një bastun të gjatë trokiste në shkëmbinj dhe, ashtu i thatë, i mpitë siç ishte, mbështjellë në qefin, hoxha

vinte rrotull shtëpisë e qante si fëmijë. Zgjidhte një litar nga brezi, ngjitej në hatulla, gajasej e ulërinte si qen dhe u hidhte lakun në fyt, po nuk i mbyste, luante me ta. Dy djem e një vajzë kishte Rakipi; vajzën e martoi dhe e trashëgoi, po djemve nuk u mori për mbarë. Fantazma nuk lajthiti një natë. U çmend Rakipi, pastaj edhe djemtë. U shkretua ajo shtëpi. Babai, kur kthehej një natë nga mali, kishte parë flakë mbi varrin e hoxhës. Akoma digjet nga inati.

— I kujt? — pyeti Diana.

Fatoja u drodh.

— Ç'pate?

— Më duket se e shoh.

— Budallallëqe...

— Pse të trazosh atë që s'të hyn në pjesë.

— Nxitojmë, — tha Vera.

— Hë, ti, çupë e mamasë, — qesëndisi Diana, — mos ia ushqe frikën Fatos.

Në shtëpi sofra ishte gati. Ato hëngrën vezë të tiganisura me gjalpë, një tas me qumësht dhe u shtrinë. Po Dianën nuk e merrte gjumi. Kthehej e vërtitej në dyshekun e ngushtë, pa mundur të mbyllte sy. Një frymë e ngrohtë, shoqëruar me gërhitje, i frynte hera-herës rrëzë veshit. E goditi me bërryl.

— Ç'ke? — foli Vera nëpër gjumë.

— S'më del nga mendja shtëpia. Fshatin e ka trembur fantazma.

— Më lër të fle, më lër...

Diana s'e ngacmoi më.

* * *

Një diell i kuqërremë ngjitej ngadalë mbi maja dhe lëshonte në atë gropë shkëlqimin e vet llamburitës. Fsha-

tarët me shata e lopata zbrisnin poshtë, ku verdhonte gruri, që trazohej nga një fllad i lehtë, dhe jeshilonte misri.

Ato shkuan të parat në zyrat e kryesisë. Djemtë erdhën më vonë. Në krye ecte Seloja.

— Mirëmëngjes, moj bija! Si u gdhitë?

— Mirë, — thanë vajzat.

— Sot s'ka sorollatje, — tha Nevruzi serioz e pështyu duart, si t'i futej një pune të madhe. — Sa të presim dhe të vendosim shtyllat, do të vijnë të tjerët të sjellin telin e motorin.

Diana thirri Ladin e Agimin dhe i hoqi mënjanë.

— Ndonjë racionalizim? — buzëqeshi Agimi.

— Lëri shakatë, — tha ajo. Dhe u tregoi për shtëpinë e vjetër, fantazmën, që flitej se kishte groposur një familje dhe mbante në ankth një fshat të tërë.

— Diçka duhet bërë, — tha Ladi i menduar. — Fshatit nuk i duhen vetëm dritat.

Heshën një hop. Ladi ngrysi vetullat e nisi të fishkëlente një melodi të njohur. Këputi një fije shkrepëse dhe e futi në gojë, siç bënte zakonisht, që kur kishte lënë duhanin. Pastaj Seloja u bëri zë të vinin. Kryetari priste në zyrë. Rrinte në këmbë pranë dritares dhe shikonte përtej maleve. Ishte një burrë shpatullgjerë, flokëkuq, me ca prenka në fytyrë. . . Duhet t'i kishte kaluar të tridhjetepesat. Në tavolinë kishte letra, shkresa e një tas duhani.

Kur hynë vullnetarët, ai buzëqeshi dhe i ftoi të uleshin.

— Kemi pasur shumë punë, — vazhdoi. — Koopeativë e re kjo, dhe unë i ri me të. Kam qenë ekonomist në komunale. Vendin nuk e njoh mirë, po duke punuar, duke mësuar. Nejse, për ju kam menduar që tani për tani të strehoheni në shkollë, vajzat te Fatoja.

— S'është puna aty, kryetar, strehimin ne e gjetëm

vetë, — u hodh Ladi. — Duam një njeri të na shpjerë në pyll dhe kafshë që t'i zbresim shtyllat që andej.

— U bëtë ventalinj, — qeshi kryetari. — Po ku ju ka shkuar në mendje?

— Te shtëpia e mallëkuar.

— Sikur e kam dëgjuar, — mblodhi buzët ai, — po s'më është bërë mbarë ta shoh. E shohim më vonë.

— Ne do të shkojmë qysh sot, — tha Diana.

— Gjynah të mos mbillet ajo tokë, — shtoi dhe Agimi.

— Edhe këtë do ta shohim, — buzëqeshi kryetari. — Këtë vit të korrim atë që mbollëm... Tani më falni. Do të shkoj në fshatin tjetër të shoh si venë të korrat. Nga dreka keni Mitatin këtu dhe e bisedoni me të.

I foli Selos në vesh dhe, kur ky mbaroi së lëvizuri duart, i rrahu shpatullat e tha:

— E, se Selon e keni në çdo kohë.

Dhe bëri të dilte. Te dera, siç duket, i lindi një mendim, se ndaloi dhe u kthye prapë.

— S'e keni keq, jo. Më vonë e bëjmë vatër kulture ose depo. Si s'na shkoi ndër mend më parë! Nejse, vjen Mitati dhe rregullojeni me të.

* * *

Deshi s'deshi, Seloja i ndoqi pas.

Shtëpia ishte e vjetër. Dukej që s'kishte pasur frymë njeriu dhe dorë nikoqireje mbi kokë prej vjetësh. Në argjilin e katit përdhes kishin mbirë bar e ferra sa një bojë njeriu. Muret qëndronin në këmbë si dikur. Rrjeta të mëdha gjahu kishin qëndisur merimangat në qoshet e dhomës. Nga dritaret e vogla me kuadrate hekurash mezi hynte një dritë e dobët, e zbetë. Tavanit i kishte rënë suvaja, trarët ishin bërë me vrima nga krimbat.

Ladi hyri i pari. Ndezi një shkrepëse, dhe kuadri i errësuar i dhomës mori dritë. Një merimangë kishte hedhur kthetrat te një mizë që lëvizte e përpëlitej në rrjetë pa shpresë shpëtimi, dhe i vinte në krahët penjëzat e hollë. Ajo u tremb nga flaka, se e la gjahun dhe u fsheh në tavan. Një lakuriq nate u përplas në mur dhe u zhduk mes trarëve.

Tej dritares ta bënin me sy mollët kuqaloshë dhe kumbullat gjatore.

Seloja ndenji te pragu dhe nxori kutinë e duhanit.

— Po ç'ju duhet këtu, mor të uruar, sikur s'kemi shtëpi në fshat!... Do të kujtojnë ata të qytetit që ju lamë mes katër udhëve, pa u futët në këtë shkretëtirë. — Donte të thoshte «të mallëkuar», po druhej se mos të rinjtë zinin e qeshnin.

— Këtu do të rrimë, — vendosën ata.

Seloja nuk e priste këtë. Kujtonte se do t'i trembte ajo gërmadhë e pabanuar, se do ta quanin këtë shëtitje dhe s'do ta zinin më në gojë. Po atyre u qe mbushur koka dhe nuk luanin nga e tyrja.

— Atëherë hajdeni i thoni kryetarit, — murmuriti. — Ai kujtoi se vetëm do ta shikonit.

— Pastaj, — tha Diana. — Tani do të rregullojmë banesën tonë.

Selos nuk i bënin këmbët të shkonte.

— Shikoni si janë sfilisur muret me pushkë nga të zotërit e shtëpisë, — tha. — Ata kishin armë dhe... kurse ju... .

— Do t'ia gjejnë anën.

Seloja iku duke murmuritur.

Dy të tjerët s'ishin futur akoma në temë. Kur iku Seloja, sqaruan gjithçka.

— Duhet të rrimë, — thanë dhe ata.

— Kjo do të jetë banesa jonë.

— Fillojmë nga puna atëherë. Të presim ferrat e dhomës.

— Pse të dhomës? Të dhomave, — foli Diana.

— Mjafton njëra, — tha Ladi. — Të tjerat kur të bëhet vatër kulture.

— Po ne ku do të rrimë?

— Në fshat.

— Ne s'ndahemi nga shokët. Apo jo, Vera?

Ajo tundi kokën pa qejf.

— E shikoni, dhe çupa e mamasë do të vijë, — qeshi Diana, e goditi lehtë me bërryl shoqen dhe iu hodh në qafë.

Qeshën dhe djemtë.

— Pra, dhomat.

— Fillojmë me tonën, — thanë ata. — Do të na ndihmojnë vajzat.

* * *

Nuk mbeti njeri në fshat pa e marrë vesh. Kudo zienin fjalët. Sekretari i partisë, Mitati, donte të pyeste si venin punët dhe u kthye nga kryesia. Rrugës ndeshi plakun 90-vjeçar, Demirin, tek hidhte këmbët çalë-çalë e murmuriste me vete. Kur pa Mitatin, qëndroi këmbët dhe mustaqet e bardha iu ngritën përperjetë si gjemba e sytë iu përshkënditën.

— Ç'janë këto gjëra që bëni, more bir!... — tha i zemëruar, duke tundur bastunin e thantë. — Pleqërojeni njëherë me kryetarin. S'është e udhës të lihen miqtë në shtëpinë e mallëkuar. Nuk është zakoni ynë ky, jo...

— Do të rregullohet, — i tha Mitati dhe i zgjati plakut paqetën e duhanit. Ai nuk ia mori, shau nëpër dhëmbë dhe iku çalë-çalë, duke trokitur bastunin...

Kur po i afrohej lëmit, që ishte ngjitur me zyrat e kryesisë, Mitati vuri re një grup grash tek grindeshin me njëra-tjetrën.

— Dhe çupat aty do të flenë? U prish dynjaja, moj korba. Uh, ditëshkurtrat! Sikur e dridhnin bishtin ato, i pashë unë që në fillim, — thoshte Metullaja, një grua gjuhëpiperkë. — Fatoja si shumë u është ngjitur. Do të roitë çupa.

— Uh, m'u bëfsh kurban i çupave dhe i çupës, — mori zjarr Paquzeja. — Ato ndenjën tërë natën mbrëmë dhe nuk kuptova një fjalë për zagarllëqe, si të vete mendja ty, po e mësuan të qëndisë me thes.

Mitati qëndroi këmbët dhe iu kthye Metullasë:

— Vëri fre gojës ti, Metulla! Ç'janë këto turpe që nxjerr nga goja? Mirë e kanë bërë vullnetarët që e vendosën të flenë në shtëpinë e Rakipit. Na dhanë një mësim të mirë edhe neve, — dhe bëri për nga dera e kryesisë.

* * *

Në mesditë dhomat ishin gati. Vullnetarët ngjitën lart teshat. Kryetari me sekretarin e partisë shkuan një copë herë.

— Si s'na kishte shkuar ndër mend, o Kadri, — tha Mitati. — Le që në fillim kishim hall që të futeshin të gjitha familjet në kooperativë, pastaj na mbërthyen të mbjellat, të korrat e shirjet... Po a lihej djerr tërë kjo tokë? Edhe shtëpia si problem s'është e paktë.

— U lumtë djemve dhe vajzave që na i shtinë në vesh.

Si u hodhën një sy dhomave, ata ikën.

Vullnetarët u shtrinë nën hijen e mollëve. Nevruzi përtypte me shije një Renetë, Diana lexonte një roman.

Agimi kishte ngjeshur kokën mes pëllëmbëve dhe shihte qiellin e kaltër në perëndim, retë e purpurta që rrinin si qeleshe në kreshtat e maleve.

Diana la librin mënjanë e tha, me vështrimin kre-
dhur larg:

— Sot vjen drita.

— Në libër apo në fshat? — qesëndisi Agimi.

— Sa i trashë që bëhesh, — e ngacmoi Ladi. — Ajo nuk e kishte fjalën aty. E dëgjove sekretarin e partisë: fshati po zjen. . .

— Epo ajo flet ndryshe, lexon romane, — shtrembëroi buzët Agimi. — Ti, Ladi, ke zotësinë të hysh në botën e brendshme të njerëzve, sidomos të Dianës.

— Ha, ha, ha. . .

Shakatë ndoqën njëra-tjetrën. Kur u err dhe në qiell vezulluan yje të shumta, ata ndezën një zjarr të madh te pragu.

Nga mulliri lëvizte një hije. Djemtë shtrënguan dhëmbët dhe mblodhën grushtat. Vajzat u strukën pas njëra-tjetrës.

— Ej, ej. . .

Që andej u përgjigj një zë. Kur u afrua silueta, në gjuhët e flakëve që lëpiheshin në errësi, shquan Mitatin.

— Përse erdhe, o sekretar?

— S'më zinte gjumi e thashë të ngjitesha njëherë këtej. Më thanë se keni një fisarmoniçist të mirë.

— Po, po. Merre, Nevruz, merre.

Të rinjtë qeshën dhe i hapën vend pranë zjarrit.

Vonë, kur flaka u nemit dhe prushin e mbuloi hiri, ata u ngritën të flinin në dhoma.

Në mesnatë, nga Shpati i Lugatit vinin ca tinguj dhe zëra që s'ishin dëgjuar ndonjëherë kaq vonë. Nënë Paquzeja mbajti vesh dhe i shkoi të birit te shtrati.

— Ngrehu merr Alikon, Seferin... dhe u shkoni në ndihmë!

— Përse? — pyeti ai përgjumshëm.

— Ja, dëgjo!

Heshtje. Në qetësinë e natës tingujt ndiheshin sikur të ishin pranë.

— Është fisarmonika, moj nënë. Kot që nuk e le dhe Faton të shkonte.

— Uh, qoftë larg!

Në dhomën tjetër Fatoja nuk mbylli sy, edhe atëherë kur zërat e këngët nuk u ndien më. Kishte frikë mos shihte ndonjë ëndërr të llahtarshme dhe u ndillte të keqen. Nëna e kishte sharë që s'kishte qenë e zonja t'i mbante vajzat, pa djemtë bënin si bënin. Të gjorave, do t'u ngelej zemra kur të shihnin atë llahtarë...

Kur zbardhi, Fatoja shkau nga krevati, u vesh pa zhurmë dhe mori përpjetë fshatit. Te stallat takoi Selon.

— Si u gdhive?

— E ç'të gdhirë! Nuk mbylla sy. Tërë natën isha me ata dhe me Mitatin, që mori mendjen e tyre.

— Si, edhe ai?!

— Edhe ai, — psherëtiu Seloja.

Yjet kishin nisur të shuheshin në kupën e qiellit. Nga lindja kreshtat e maleve ishin skuqur, po dielli s'kishte dalë akoma. Morën sipër nga mulliri, pastaj u hodhën në monopatin nën shkëmb. Nga lart erdhi një zë i hollë.

— Fato! Fato!

Një forcë e pakuptuar i ndali në vend. Ngritën kokën

nga vija e ujit dhe panë Verën që shihte nga ata dhe lëvizte në ajër. Diana, me fytyrë të shkumosur, u hidhte ujë syve.

Morën frymë të lehtësuar.

— A s'të thashë, Fato? — i foli me të qeshur Diana dhe iu hodh në qafë.

Fatoja s'kishte se ç'të thoshte. I lëmoi flokët e gjatë dhe i pëshpëriti:

— Më dukesh si zanë që del nga vija e ujit, si ato që tregon gjyshja në përralla.

— Mitati, ku është? — foli Seloja i ngrysur.

— Tani sa u ngrit.

Ai u ktheu shpinën dhe ngau hapat e tij me të shpejtë. Poshtë mullirit dëgjoheshin zëra.

Atë ditë fshatarët e filluan punën më vonë.

B A B A I

— Ja, ky çekan të rriti e të bëri kaq, të bëri ky që je,
— i thoshte sa herë babai.

Piktori buzëqeshte, po nuk merrte inat. Ia bënte borxh vetë nganjëherë, pa plaku merrte zjarr dhe fliste ashtu. Ai e dinte mirë se me djersën e ballit dhe forcën e krahëve e kishte mbajtur babai familjen, e kishte mëkëmbur të birin, i kishte hapur sytë dhe i kishte dhënë shkollën që kishte dashur vetë. «Merre atë, — i thoshte ai për penelin. — Mbaje në dorë dhe përdore si unë çekanin». «Po, do të mundohem», — i përgjigjej piktori dikur, kur ishte ende nxënës liceu.

Një jetë të tërë e kishte mbajtur babai çekanin dhe s'ishte turpëruar ndonjëherë. Vetëm atë i kishte lënë të birin. Në fillimet e tij piktori e kishte vizatuar, dhe babai, kur e kishte parë, kishte ulur vetullat e mëdha, të thijnjura mbi gropëzat e syve dhe nuk kishte folur. Kushedi çfarë mendonin atë ditë sytë e tij ngjyrë ulliri. Rrallë dinin të qeshnin ata. Dhe fjalëve të pakta, kur merrnin fluturimin tej shtegut të buzëve, duhet t'ua vije veshin. Ai i mbante ato si ca zogj të rrallë në kafazin e trurit dhe nuk i lëshonte kot. Pastaj edhe njëqind vetë të mblidheshin për t'ia kundërshtuar, s'ia hidhnin dot poshtë. Nuk ishte kokëfortë plaku, po kishte logjikë të fortë e durim për t'i shkoqitur gjërat. Dhe ta mbushte mendjen

më në fund. Fliste për ato që i kishte parë syri dhe i kishte dëgjuar veshi. Për të tjerat heshtte. «Kur në hambarin tënd ke krunde, bli më mirë», — thoshte ai.

Ishte rrudhur e plakur, po s'dinte të rrinte kurrë në një vend, sepse, sipas tij, puna të shton brazda në ballë, dëborë në flokë dhe mend në kokë. Këtë, më mirë se askush tjetër, e kishte kuptuar Iloja, shok i piktorit dhe letrar i ri. Hahej me plakun, ia gjente telat, dhe ai zbrazte qesen e kujtimeve. Një thënie të tij: «Mate njeriun me derhem in e floririt, jo të kripës», Iloja e kishte shtjelluar në një tregim që më vonë ishte botuar në gazetë.

— Nuk duhet ndenjor me ju të penës. Çdo fjalë e nxirrni faqe njerëzve, — kishte thënë babai kur ia kishin treguar.

— Po si do të mësojnë të rinjtë! — kishte qeshur Iloja pa të keq.

— Pse, nga unë do të mësojnë?

— Po nga kush tjetër?

— Ashtu është, ashtu, — ishte përgjigjur babai pasi kishte heshtur një hop.

... E ç'të kujtonte më parë! Copëza kujtimesh i gëlonin pareshtur në kokë, dhe ai nuk dinte kë të merrte e të përfytyronte të plotë.

Ngjiti shkallët dhe shtyu derën në mëdyshje. Ajo u hap me një kërcitje të butë e të lehtë, dhe para syve i doli kuadri i dhomave. Ani i kishte bërë dritë dyshemesë. Nga muret e bardha i erdhi në hundë sherbeti i gëlqeres. «Duhet mbushur kjo zbrazësi», — mendoi. Një çast i erdhën në mendje peisazhet e trishtuara të Levitanit.

Tani, në prag të prishjes së shtëpisë së vjetër, ai kishte menduar dëndur për mbartjen në ndërtesat e reja tek agjencia. Dhe të tjerët, babai, nëna, Ani e kishin pritur këtë po me aq padurim, po kishte ndodhur diçka e papritur, trallisëse, dhe të gjithëve u kishte rënë ai vrulli i

parë. Ai e kuptonte se çdo qenie i nënshtrohet prologut dhe epilogut, por megjithatë ishte e rëndë ta provoje këtë gjë vetë.

Nëna s'kishte dashur të iknin as sot. Te krevati, tavolina, arka, i bëhej se lëvizte vizioni i të shoqit. Me Elsën trevjeçare në pëqi, asaj gruaje nuk i shqitej nga mendja e kaluara me mjaltin dhe helmin e saj... Me të kishte kaluar çdo gjë. E si mund ta harronte të shoqin!

Piktori hyri në kuzhinë. Qetësi. Trokitjet e hapave u përplasën në muret e bardha dhe i gjëmuan në vesh. Ndaloj te dritarja. Mbështeti bërrylin te parvazi dhe ngjeshi tëmthat në grushtin e dorës.

Muzgu, rëndë-rëndë, po ulej në çatitë e kuqe dhe mbi tarracat e grinjta të ndërtesave. Atje tej, në vargjet e kodrave që zbrisnin në qytet, varret e dëshmorëve i ngjanin një shqiponje në fluturim. Babai nuk e kishte pasur për gjë të ngrihej në të aguar, të ngjitej përpjetë e të shtrihej pranë burimeve që gurgullonin nën akacjet e blerta. Më i çelur kthehej që andej, po rrallë fliste.

— Bukur e ka bërë, mor bir... Dhe atë partizanin me grushtin lart e ka qanitur... Bënë shumë ata për këtë truall.

Kur e rastisi njëherë në studion e të birit, ia tha edhe vetë skulptorit këtë. Skulptori i tha se i biri ia kishte ushqyer e miratuar bocetin. Piktori kishte buzëqeshur. Plaku ishte ngrysur e kishte tundur kokën.

— Posi, posi, të thanë shtatë a tetë, po e bëre si dije vetë. — Dhe iu kthye të birit: — Tjetrit hiqi kapelen, çmoja djersën, po mos e ngjit në ballin tënd, si të kesh dërsirë vetë.

Ishte zënë ngushtë piktori dhe i kishte treguar një peisazh të vetin, për t'i thënë plakut se dhe ai punonte. Ai kishte mbledhur buzët. Kundërvënia e peisazhit me mendimin e bocetit nuk i kishin pëlqyer.

— Të mos ma jepje tani, or bir. Punën lëre të flasë vetë. Mos iu ndaj, i rri ngrehur, po mos i krih bi-shtin.

Kur ishte kthyer nga instituti, piktori kujtonte se nuk kishte ç'të mësonte më. Punonte me qjef një portret punëtori.

— Shumë të trashë ia ke bërë krahun.

— Është forca e punëtorit, baba.

— Forca do mendje, bir. Vëre në vesh këtë.

Ai i kishte dhënë të drejtë. Babai vinte dhe më pas në studio. Piktori bëhej flakë i kuq, lëvizte i shqetësuar poshtë e lart dhe nuk ia hiqte sytë mimikës së tij para tablove. Kur plaku i jepte zemër, ai nuk i lëshonte penelat gjer në mesnatë; kur ai shfaqte pakënaqësi, piktori dilte në rrugë dhe rikujtonte ku ishte rrudhur më tepër babai, çfarë ndjenjash i kishte yshtur kompozimi.

..Babai i kishte lënë para një jave. Askush s'e kishte pritur vdekjen e tij.

Ishte një pasditë e zakonshme vere. Nëna merrej me Elsën në oborr. Piktori lexonte gazetën, mbështetur në shezlong. Ani s'ishte kthyer nga puna. Koka e bardhë e Qaniut u shfaq në derë, dhe Elsa iu turr buzagaz:

— Hasani ku është? Na pret makina të shkojmë në fshat për korrrjet.

— Lart e ke. Bën sandalet e së mbesës. Tëng-tëng, tërë ditën me çekan. Se mos mbetën të korrrat për ju, — qeshi nëna. — Ehu, sa njerëz ka aty!

— Edhe ne do të bëjmë tonën; — tha Qaniu dhe ngjiti shkallët e hyri në korridor.

As trokitje çekani nuk dëgjohej, as frymë njeriu nuk dukej. Qaniu u fut në sobalkë. Babai kishte rënë mbi arkën e vjetër. Zuri kokën me duar e lebetiti. Të gjithë u ngjitën lart. Babai kishte mbështetur kokën në kapak. Dukej sikur flinte me një mendim të bukur. E ngritën që

aty dhe e shtrinë në krevat. Çekani ra me zhurmë në dysheme. Ai tingull i ngeli në kokë piktorit, tok me gishtërinjtë e gjatë, të hollë, ku ishte mbështjellur sandalja e Elsës. Piktori s'kishte pasur kohë të mendonte. Thirri një mjek, por ishte vonë. Ai tha se duhej të ishte infarkti i miokardit. Piktorit nuk i bëhej ta besonte këtë sëmundje. Babai s'kishte bërë «oh» një herë. Po ç'rëndësi kishte të hynte në debate pa bukë? I ati s'ishte më. Nëna vuri kujën, Elsa e vogël u sul te gjyshja dhe qau, e trembur nga dëshpërimi i saj.

— Vëre gjëkund këtë, — Qaniu e kapi për krahu dhe i dha çekanin. — Bëhu burrë tani.

Ishte mundur ta mbante veten piktori, po një lot i nxehëtë i kishte rrjedhur në faqe.

Jeta e babait s'i ishte ndarë këto ditë. Tëng-tëng godiste çekani në kudër. Çdo gozhdë që ngulej në shollë, a çdo gjilpërë që harlisej në lëkurën e tendosur, i ngjallte plakut rrudha kënaqësie. Pragu i shtëpisë nuk e mbante, edhe kur mori pensionin. Ngjitej kodrave, merrte ushqimet në dyqane, kthehej nga reparti i riparim-shërbimeve. Kur shihte që shokët e tij ishin të zënë dhe përtej banakut prisnin shumë njerëz, ai vente përparësen dhe u mbaronte punë shpejt. Dhe këpucët e familjes vetë i meremetonte atje. Kur donin vetëm ndonjë gozhdë, ai blinte në dyqan dhe i bënte në shtëpi.

U grind me nusen një herë. Ajo kishte çuar sandalet në një dyqan tjetër, pa biseduar me plakun. Ai u bë hundë e buzë.

— Pse, ç'jam unë, mballomaxhi që nuk di të vë një takë? Duart e reshkura m'u plakën, po nuk e humbën guston.

Nusja, e skuqur, e turpëruar, shkoi në dyqan. Erdhi me sandalet dhe ia dha plakut. Pas një ore ai u kthye tërë qejf.

— Merri, moj nuse, merri, dhe, po s'të pëlqyen, shpjeri prapë aty.

— Të lumshin duart, baba!

Dhe nuk ia prishi më plakut. Ai vërtet bëhej nevrik, po dorën e kishte të artë.

Brenda transparencës së dritareve mbrëmja u derdh lehtë-lehtë. Të nesërmen në mbrëmje, nga tavani do të rrezatoheshin ngjyra të verdhëreme. Djemtë e mëhallës do të shkuleshin të gjithë të sillnin rrobat e mobiljet. Piktori do të vriste mendjen ku t'i vendoste. Gjergji, ai piciruku i mëhallës, deshi arkën e vjetër për folenë e pëllumbave. Ai i kishte premtuar se do t'ia jepte me të shkuar në apartamentin e ri. Me mendimet për sistemimin e divanit e të bufesë u ngatërrua dhe fotografia e t'et. Sa me gaz kishte dalë babai aty! Ia kishin kërkuar në ndërmarje si kujtim në prag të pensionit. Piktorit nuk i kishte pëlqyer ajo fotografi. Rrallë qeshte babai, po fotografi ashtu e kishte fiksuar. «Jo, jo, — mendoi piktori. — Sytë e babait i ngjanin një deti të shqetësuar me tërë vrundujt e tij. Kjo ka qenë rastësi. «Po as ai nuk kishte ndonjë gjë për babanë, për brezin e tij. Tani që çekani kishte rënë nga dora e tij dhe arkën e vjetër do ta merrte Gjergji, piktori e ndiente më shumë këtë. A do të mundte ai të fuste në apartamentin e ri, të ravijëzonte një kompozim që i ati, po të ishte gjallë, të thoshte:

— Shumë më ngrite, mor bir.

— Është puna jote, baba. S'mund të të përfytyroj ndryshe.

— Si gjithë të tjerët, o bir, — do të psherëtinte plaku.

Po, si gjithë të tjerët. Këto kishte bluar këtë javë. Çekani dikur ishte vizatim në dosjen e tij. Tani i kishte humbur ajo fletë. A do të mundte ai t'ia vinte përsëri në dorë, që plaku të shikonte nga tabloja me kënaqësinë e njeriut që mbërthen këpucët, që ata që e kishin njohur

të thoshin: «Po, po, kështu bëhej ai kur ulej dhe merrte cekanin».

«Cila ishte koha më e artë e babait», — pyeste veten, po nuk mori përgjigje. Dhoma e zbrazët iu duk e mërzitshme. Në çaste të tilla ai donte të këmbente dy fjalë. Të nesërmen zëri i Elsës do të cicëronte në dhomë, do të kërkonte gjyshin, dhe ai do t'i buzëqeshte nga fotografia. Pastaj ajo do të humbiste pas lojës. Çekani mund të ishte diku në dhomë. «Duhet vënë gjëkund», — iu kujtua biseda me Qaniun.

«Në dorën e tij. Ta shohim të gjithë», — sikur i foli një zë nga brenda.

Çfarë e bashkonte babanë me njerëzit? — mendoi. Puna, jeta e përditshme, i erdhi një zë. Po ku ta gjente këtë lidhje tani që babai s'ishte më?

I lindi ideja për një triptik; babai rrihte në kudër, mes shokëve me Elsën. Kur e hanin subjektet, piktori nuk qëndronte në një vend. Doli. Në bulevard lëviznin njerëz. Kërkonte me sy në turmë ndonjë bashkëmohatar të babait. Diçka të përtafërt me babanë do të gjente partjetër. Çdo hap që hidhte i shtonte një mendim. Te qoshja e studios u kthye. Çdo gjë e kishte të qartë. Mjaftonte të kishte letër dhe të skiconte...

G J A K . . .

Ndërsa buzëqeshte për vetitë çudibërëse të fenerit në dhembjet e barkut, për Dhorin që u bë baba me dy fëmijë, për plazhin, ku do të shkonte pas ca ditësh (se vitin e ardhshëm s'mundej, pasi do të bëhej baba dhe vetë, e fëmija patjetër do kujdesje), dëgjoi emrin e vet nga një zë i hollë dhe ngadalësoi hapat.

— Alti, si është? — tundi kokën Ola trupvogël e sygështenjë dhe eci bri tij e shqetësuar.

Ai as që e vrau mendjen t'i përgjigjej pyetjes dhe vështrimit të saj.

— Shpresa, si është, Shpresa?

Ai çoi supet e mblodhi buzët. Një kënaqësi e patreguar ende i lëvrinte në shpirt, buzëqeshja e lehtë, pak naive nuk i ishte fshirë nga fytyra.

— Mirë është. Si gjithmonë.

«Si duket nuk e di», — mendoi ajo. Shpresa i kishte folur ndryshe për këtë njeri. Ajo e kishte shoqe dhe nuk i kishte fshehur asgjë. T'i kishte thënë të vërtetën, apo të kishte mbajtur rezerva? Ai kundërmonte erë alkool dhe shihte buzagaz. Behari ishte ulur në fytyrën e tij.

— Si, si gjithmonë? Pse, nuk e di?

Ajo kishte menduar t'i thoshte se të tilla raste ndodhin, por, e shtyrë nga era e alkoolit, që i ndillte një ngërdheshje, i harroi të gjitha, dhe një damar iu tendos në tëmtha;

— Ajo u aksidentua, dhe ti...

Ai shtangu. As një pejëzë muskuli nuk i lëvizi në mollëzat e faqeve. Bulëza djerse i vesuan ballit si kristale të ndritshme, ninëzat e syve iu bënë më të mëdha, si të zaptonin gropëzat nën harqet e vetullave.

Ajo u pendua që ia tha në këtë formë.

— Mos, Ola! Thuaj që nuk është e vërtetë, — pshe-rëtiu ai.

Ola uli kokën.

— Mos... po si?

— Tri orë ka, — murmuriti ajo. — Një detal u shkë-put nga tornoja dhe e goditi në kokë.

— Ku është tani?

— Në spital.

— Kur e çuan?

— Menjëherë pas aksidentit.

Alti shtrëngoi tëmthat me duar, si të dëbonte atë shkëmb të rëndë që iu ul papritur në tru, hodhi sytë për-tej rrugës dhe i ktheu shpinën. Bëri dy-tre hapa, pastaj ia dha vrapit, po zëri i Olës e solli në vete. U ndal e ktheu kokën. Ajo ia bëri me shenjë të priste. Pastaj ecën krah për krah. Ai nxitonte hapat, si të donte të ndalte sekondat.

— Po si ndodhi, Ola, si? — pyeste vazhdimisht dhe, ndonëse e dëgjoji kaq herë nga goja e saj, nuk i bëhej të besonte.

— Po mjekët ç'thonë?

Ola nuk u përgjigj menjëherë. Solli ndër mend bise-dën me mjekun kirurg.

«Të shohim, rëndë është... po kanë ardhur edhe më rëndë e kanë jetuar përsëri. T'i hedhim gjak njëherë, pastaj këtu jemi...»

E kishte pasur vështirë të fliste prerë, t'u përgjigjej vështrimeve që e ndiqnin në çdo lëvizje, në një kohë kur

dyndeshin dy forca dhe nuk dihej kush do të fitonte. Ndaj dhe Ola druhej të jepte mendim.

Arritën te dera e spitalit.

Portieri e njohu Olën. Para dy orësh kishte ndenjur me të dhe kishte këmbyer dy fjalë për aksidentin. Ai hapi derën.

— Akoma po i hedhin gjak, — psherëtiu. — E shkreta vajzë. . .

Alti ishte në mes të derës.

— Shok, po ti ku shkon? — foli portieri.

Ola kafshoi buzën e tha me gjysmë zëri:

— I shoqi.

Alti shtrëngoi tëmthat që i rrihnin fort.

— Ola, ku është, ku?

— Në dhomën tetë.

Me katër hapa ai përshkoi oborrin e spitalit dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u gjend në korridorin e gjatë e të ngushtë të pavionit të kirurgjisë. Gjak, gjak. . . Sytë iu bënë më të mëdhenj, dhëmbët i kërcëllinin. Zemra sa nuk i shkulej nga kraharori: si do të jetë, si? Shtrati ishte vënë në mes të dhomës. Në kryet e të sëmurës njohu Dritën, me një bluzë të bardhë hedhur kraheve, dhe një infermiere. Një shufër hekuri ngrihej anash shtratit, në majën e së cilës, në disa rrathë, ishte kthyer përmbys një flakon gjaku. Alti pa në fundin e grykës tubin e llastikut që lidhej me një shufër të qelqtë. Në fund të tubit një age kishte humbur majën në damarët e Shpresës. Në transparencën e xhamtë ngadalë rrëzohej gjak.

Këto i kaluan para syve vetëtimthi. Vështrimi i tij u ndal te Shpresa. Koka me flokët gështenjë ishte mbështjellë me fasho të bardhë. Vende-vende, në bardhësinë e fashos vizatoheshin njolla gjaku, që ngjasonin me zambakë të kuq. Ai mundi t'i shihte gojën, sytë, hundën, mjekrën e vogël. Qerpikët ishin ulur si dy harqe të zeza, të

vogla, të patundura në atë lëkurë të zbetë si alabastër. Dhe nuk u përmbajt.

— Shpresa, Shpresa! — u turr mbi të, por infermierja e ndaloi. Koka e së sëmurës lëvizti ngadalë. Siç duket, pati dhembje, se kafshoi buzën e poshtme. Harqet e vetullave u munduan të ngriheshin, por ndenjën aty ku ishin më parë.

Alti s'mundi të qëndronte në një vend. Ecte nëpër dhomë pa ditur se ç'të bënte dhe nuk ia ndante sytë infermieres, Shpresës, tubit të xhamtë, ku pikonte gjaku, dhe befas iu bë sikur ato globe të vogla shkuleshin brenda transparencës së kanalit me rropamë, si ortiqet kur lëshohen prej kreshtave në hone. Që andej zinte fill një refren që i rrihte si çekan në tëmtha: «Gjak, gjak...»

— E, si është? —

— Rëndë, — tha infermierja, — por mjeku ka shpresë. Flakoni i dytë sikur po i sjell çehren.

Donte të kujtonte çastet më të bukura që kishte kaluar me Shpresën, po ato ishin të shumta e përplaseshin në trurin e tij të lodhur si dallgët në shkëmb. Befas, s'di pse, i erdhi ndër mend që babai i Shpresës kishte zënë kabinë e pas katër ditësh i priste në plazh. «Duhet lajmëruar», — mendoi. Po fytyra e zbetë e sytë e pulitur ia largonin të gjitha mendimet e tjera. Ai nuk ishte në gjendje të shkoqiste nga shprehja e fytyrës së saj në buzëqeshje ajo apo jo. Në dhomë hyri mjeku dhe ata dolën në korridor.

— Po ti ku ishe? — pyeti Drita. — Në shtëpinë e Shpresës s'kishte njeri. Alarmuam uzinën, por na thanë se ishe sëmurë. Dhe në shtëpi pamë gjithashtu. E sollëm shpejt. Mjeku e futi në sallën e operacionit, pastaj i vuri gjakun.

«Mjaft, mjaft!» — donte t'i thoshte Alti, por nuk nxori zë. Pështyma i qe tharë në fyt. Dhembja e kokës

po e shtrëngonte si me darë. «Gjak, gjak!» — i kumbonte në vesh si një vikamë shpërthyesë e një orteku që përplaset thellë në hon.

Drita me Olën ikën. Do të ktheheshin më vonë. Alti s'mund të qëndronte në një vend, por as dhe të lëvizte. Lëvizjet e siluetave përtej xhamit të bardhë të derës e mbanin mbërthyer në vend. U kërrus te vrima e çelësit: shufra e hekurt, tubi i qelqtë, globet e vogla, të kuqe, që rrëzoheshin me bubullimë, si ortiqet në hone. Mjeku iu afrua Shpresës dhe i kapi dorën. «Si duket ndjek pulsin», — mendoi Alti, po lëvizjen e fytyrës nuk ia pa që të kuptonte rezultat. «Si është, ai?» — foli, por askush nuk i ktheu përgjigje. Pas shpine nuk kishte frymë njeriu.

Refreni ngacmues e çukiste në kokë: gjak, gjak... Ai s'e linte të qetë asnjë çast, dhe Altit i vinte të hante veten me dhëmbë për atë proçkë që kishte bërë...

Pllakatat «Bëhuni dhurues gjaku!» para një jave ishin vendosur te klubi i kulturës. Mbledhja ishte bërë para dy ditësh. Të gjithë kishin ngritur dorën në shenjë aprovimi. Edhe ai. Kur dolën nga salla, se kush tha që gjakun e merrnin me një gjilpërë të trashë në damar.

— Si, si...? Mos marrin shumë?

— Jo, shishja është e graduar.

«E përse kjo, — tha me vete. — Hiq nga trasta dhe mos e vër gjëkund!».

Qendra e zërit në ndërmarrje foli për iniciativën qysh në mëngjes. Pasdite do të shkonin të dhuronin gjak. «E përse t'i thuash sherrit lepe?» — përsëriti me vete dhe kërkoi rrugën e shmangies.

Së fundi e gjeti.

Doli që poshtë makinës ku po vinte një gomë, me grushtin ngjeshur në bark. Iu kujtua se vitin e kaluar, kur e operuan Shpresën për apendicit, dhembjen ajo e kishte në anën e djathtë.

— Ç'ke? — e pyeti Genci.

— Më dhemb këtu.

— Mos është apendicit?

— Ku di unë.

Erdhi përgjegjësi i turnit.

— Shko me Gencin.

— Jo, jo, s'më ka zënë shumë.

— Shko, shko që tani. Ku i dihet, — tha përgjegjësi.

Ai deshi të dërgonte dhe Gencin me të, por Alti nuk pranoi... Makina duhej të dilte nga revizionimi brenda ditës.

Dhe ai, ashtu i përkulur, kaloi oborrin e SMT-së dhe vazhdoi rrugën larg. Kur ktheu kokën pas, korpusi i ndërmarrjes së vet kishte mbetur përtej bllokut të apartamenteve në hyrje të qytetit. Drejtoi trupin dhe u koll lehtë. Te mjeku kirurg s'kishte përse të vinte. Ç'do të thoshte ai? Të nesërmen do t'u thoshte shokëve se e kish-te prishur ushqimi, nuk ishte apendicit. Do të rrinte çehrevrarë, dhe ata nuk do të dyshonin për kurdisjen e tij.

Nuk i bënin këmbët të shkonte në shtëpi. Po ku t'i shtynte këto orë sa të kthehej Shpresa? Në bulevard s'kishte lëvizje. Doli njëherë nga kinemaja. Nga xhami i pasticërisë aty pranë dëgjoi një trokitje. Dhori, një tor-nitor i SMT-së, ia bënte me dorë. Alti u fut në pasticëri.

— Hajde më uro, — belbëzoi ai.

Alti kujtoi se do ta pyeste përse kishte ikur aq shpejt, po kur pa sytë e tij të tkurrur nga pija, u lehtësua.

— Për se? — tha.

— Më lindi gruaja.

— Uh, të të rrojë! Po çfarë?

— Vajzë. Djalin e kam.

— Me jetë të gjatë të dy! — qeshi Alti, po nuk vendoste të ulej. Aty pranë nuk i zuri syri ndonjë të njohur, po s'dihej, mund të vinte.

— Po shkoj, — tha.

— Nuk të lë, jo!

— Ika dhe nga puna. Më dhembte barku, — dhe psherëtiu. — Vajta dhe te doktori.

— Hë, se të shëroj unë, — buzëqeshi Dhori me naitet. — Një fërnet dhe fiuuu në këmbë.

Porositën. Alti u shëmtua në gllënjken e parë. E dyta iu duk më e këndshme. Pastaj morën prapë. Dhe ai nuk mbante mend më sa qenë bërë...

Pikë-pikë rrëzoheshin globet e vogla në kanal in e xhamtë. Dera u hap përgjysmë. Ai pa mjekun përkulur mbi shtrat dhe infermierën të dilte me një flakon të zbratur gjaku e të futej në sallën e operacionit.

— Po mbaron, — murmuriti ai. U mat t'i thoshte se ishte gati të jepte gjak, edhe pikën e fundit, por iu bë sikur dikush e zuri për fyti e nuk e lëshonte.

Iu kujtua ai burri i trashë me mollëzat e kuqe të kërcyera të faqeve që kishte ardhur i ftuar në mbledhje. Drejtori kishte thënë se nga gjaku i tij kishin shpëtuar shumë njerëz. Burri kishte buzëqeshur pa të keq dhe kishte ulur kokën. Alti e kishte marrë inat.

Infermierja doli nga salla me një flakon gjaku dhe hyri në dhomë. Nga dera gjysmë e hapur ai pa Shpresën të puliste qepallat. Alti u drodh. «Është gjallë, — mendoi. — Sa mirë, gjaku po e bën të tijën. I kujt të jetë ai gjak që Shpresës po i hap qepallat, po i jep ngjyrën e jetës? I Gencit, i përgjegjësit të turnit, i atij burrit që buzëqeshte?..»

Vetëm i tiji nuk ishte. Alti nuk ishte ndarë nga shokët asnjëherë, kurse sot... Ai nuk e dinte grupin e gjakut të vet. A përkonte ai me atë të Shpresës?

Këtë ai nuk ia falte vetes.

FRYNIN ERËRAT E MORAVËS

— Veremin na shtiu misri e na griu barkun, ndaj po t'i jap vezët, pa bërë fjalë për pazarin. Dua të mbaroj një hall që më ka rënë në derë dhe të marr një dorë grurë. Po dije, pa hile i ke, nuk janë të vjetra, se ato, të uruarat, nuk bien përdhe nga ne. Pa merak t'i kesh dhe t'i hash gëzuar!

Kështu i foli xha Mersini këpucarit Vaskë, duke hekurosur të hollat në portofol; pastaj, si e futi atë në xhepin e brendshëm të xhaketës së leshtë, i dha një «njatjeta» me dorë dhe kapërceu pragun e dyqanit. Bëri të shkonte poshtë rrugës që shpinte nga pazari i drithit, po ndërroi mendje. «Nuk boshatisen thasët, jo, — tha me vete. — Gruri qelbet në hambarë, kurse fukarasë i gërhasin zorrët, se nuk i qëndron paraja në xhepat e shpuar dhe s'ka me se ta blerë. Më vonë, kur të ngryset, mbase bie pazari dhe e japin me ndonjë lek më pak. Mua më marrin hejbet më shumë!»

Ishte një mesditë e ftohtë shkurti. Nga grykat e Moravës frynte era me tërsëllëmë, po njerëzit i kishin lënë shtëpitë ku brambullinin zjarret në vatër. Diçka kishte ndodhur tek ata. Dhe plaku e shihte në çdo hap që hidhte, në çdo vështrim që takonte, në çdo frazë të shkëputur që i zinte veshi.

Drang... drang... kumbonin qepenat e dyqaneve në

ajrin e ftohtë. Dëbora që kishte zënë ditë më parë me slloga të mëdha nuk kishte lënë gjurmë në rrugë e xhade; vetëm tutje mbi qytet larushonin kreshtat dhe gropat e maleve.

— O Pilo!

— O Vaskë!

— O Nasi!

— Nuk do ta ndrisësh me dy minuta punë. Lëre tashti...

— Erdha.

— Drang... drang... uleshin qepenat dhe njerëzit ia merrnin poshtë pazarit. Shumë mahmurë iu dukën xha Mersinit. Për moskamje flisnin. Ç'të kishte ndodhur?

Nga dera e dyqanit të rrobaqepësisë, te qoshja e rrugës, dy djem gjashtëmbëdhjetë - shtatëmbëdhjetëvjeçarë dolën me vrap, si t'i ndiqte pas njeri. Hidhnin hapat pa kujdes dhe kthenin kokën pas.

Për pak sa nuk u përplasën me të. Xha Mersini shau i nevrikosur dhe rrotulloi shkopin e thantë në ajër, po djemtë ishin larg. Një burrë me borsalinë ishte varur te parmakët e ballkonit mbi dyqanin e rrobaqepësisë dhe shfrynte tërë inat.

— Shkoni, shkoni me rrjepacakët, thyeni qafën, po vëth në vesh jua kam! Kur të shikoni rrzën e zverkut, do të ngjyeni më bukën time!...

Xha Mersini ngrysi vetullat dhe mblodhi buzët. Kujtoi se burri me borsalinë e kishte me të, po ndoqi vështrimin e tij dhe e kuptoi shpejt që ishte gabuar. Djemtë kishin kthyer qoshen. Këpucarët, rrobaqepësit zbrisnin poshtë rrugicës.

«Ku shkojnë?» — mendoi plaku e psherëtiu dhe bëri përpjetë nga depoja e kripës.

Dielli ishte ngjitur në kupë të qiellit dhe lëshonte mbi çatitë dhe kalldrëmin rrezet e ftohta të një dite dimri.

Një djalë shtatmesatar, me fytyrë vvarëlie rëndonte te kandari i kripaxhiut dhe nuk e linte rehat burrin që vinte rrotull kadeve të kripës, duke fshirë herë-herë duart e reshkura me përparëse.

— Mbylle, de, mbylle! Na presin. Vetëm ne mbe-tëm në bisht.

— Ja, de, ja...

Kripaxhiu fërkoi duart, si të hiqte qafe kokërrzat si kristal të kripës, dhe hoqi mësallën. Xha Mersini i zgjati qesen.

— Nuk kemi nge sot, — foli kripaxhiu tërë nerva.

— Vër dorën në zemër dhe më jep dy okë, — iu lut xha Mersini. — Kam bërë goxha rrugë. Si të më nxje-rrësh bosh?

Kripaxhiu u koll, hodhi sytë nga djali, pastaj rrëmbeu qesen dhe foli më shumë për vete, se për atë që ishte mbështetur mbi shkop dhe rrinte i kërrusur.

— Nesër vije, a derëbardhë. Sot e gjete ditën, që do t'ua shkulim dhëmbët!..

Ata mbyllën portën dhe morën poshtë gazinos.

«Një në hejbe, — tha plaku me vete. — Dhe pak e mbarojnë porositë e plakës».

Hodhi hejbet në sup dhe nxori kutinë e duhanit. Tek dridhte cigaren, i vetëtiu një mendim. Duhet të nxitonte në postë - telegraf. Mos i vinin llozin dhe ata, si këpu-carët e rrobaqepësit? Ç'vlente tërë ajo udhë për dy okë kripë dhe një dorë grurë, nëse do t'i bëhej mbarë ta merrte edhe atë? Kur të arrinte në shtëpi, prapëseprapë Sanija nuk do të shikonte hejbet, po për «kartën e shpejtë» do ta pyeste në fillim. Me sa ankth e priste ajo këtë dërgatë! Dërgimi i saj i kishte merakosur të dy pleqtë, veçanërisht Sanijen. Burri nga natyra është më i përmbajtur, më i shtruar, më i qetë, e vë në kandar çdo gjë që i vjen rrotull. Kur ajo i kërkon forcën e krahut dhe urtësinë e mendjes,

pështyn pëllëmbët dhe i hyn punës, ndryshe pret gjakftohtë, duke tymosur duhan të dredhur a duke thithur gllënjkat e një gote që trubullon.

Dhe xha Mersini kështu mendoj së pari, po dita-ditës shqetësimi për të bijën, që Sanija orë e çast s'e lëshonte nga goja, si një sëmundje ngjitëse, e kapi dhe atë. Kishte martuar dhe fëmijë të tjerë, po Refijen, çupën e vogël, sikur e donte më shumë dhe e ndiente mungesën e saj. Të mëdhatë hynin e dilnin me dhëndurët në krye të çdo muaji, se në Korçë ishin, kurse për të voglën, që e kishte larg, i digjej shpirti. Ia kishte dhënë një qymyrxhiu në fshatin e tyre, po ai dy-tre muaj pas martesës se nga kishte dëgjuar që andej nga Tirana qymyrxhinjtë nuk ishin aq me bollëk si në fshatin e tyre, kështu që mund të nxirrje ndonjë send më tepër. Kurseu ca para, mori dhe ca borxh dhe bëri si bëri e shkoi me nusen.

U ngrysi një mot që kur Refija iku dhe s'u duk një herë. Rruga ishte e gjatë, e lodhshme, dhe makinat rrallë e tek shkonin në atë ecejake. Pleqtë vunë krahë dhe sa nuk fluturuan kur morën letrën e parë. Nga fundi i dhjetorit ishte nisur ajo letër. Atyre u ra në dorë nga mesi i shkurtit. Kështu u kishte thënë hoxha i fshatit: «Jam me barrë, — shkruante Refija. — Nga fundi i janarit duhet të lind». Janari kishte kaluar, shkurti më të dalë ishte dhe përsëri asnjë lajm. Letra e shumëpritur po vonohej, asnjë zë miku nuk po e sillte sihariqin.

— Të dyzetat fëmija duhet t'i bëjë te gjyshja, — thoshte Sanija.

I shkonin në mendje aq e aq gra të reja që lindja e parë i kishte shtënë në gropë tok me fëmijën. Kështu t'i kishte ngjarë edhe Refijes?... Po lajmet e këqija vijnë shpejt, mbyll derën dhe oxhakun, po të duash. Çdo gjë me këmbë e me krahë, si ta shtyjë dikush, do të mbajë hapin e fluturimin te pragu dhe do të të pëlçasë mandatën

Po as kjo nuk vinte.

U prish qetësia e plakës, vërtitej nëpër dhoma e oborr dhe nuk dinte se ç'të bënte. Gjithë sendeve u ndryshoi vendin. Kështu shtynte kohën dhe humbiste mendjen. Në punët e shtëpisë nisi të lajthiste, gjë që më parë nuk i ndodhte kurrë. Një herë gjellës i hodhi sheqer dhe çajit kripë.

— Mblidh mendjen, plakë! Si të tjerat, edhe ti... — kishte thënë ai pikë e vrer dhe kishte hedhur lugën në sofër, pa e futur më në pjatë.

— Hë, se kështu do të bënte kushdo, — ia kishte pritur ajo. — Preji gishtat e më thuaj, cili nuk të dhemb? Sa të marr vesh, pastaj do të më shohësh.

Po lajmi s'dukej të vinte. Sanijen nuk e mbante vendi. Të keqen mendojnë njerëzit kur lajmi, si një udhëtar i çalë, vonon të japë përgjigjen. Nuk e përmendin se çfarë e keqe, po e shohin si diçka që u ka zënë udhën dhe nuk i lë të marrin frymë. Xha Mersini kafshonte mustaqet e thinjura, nxirrte çibukun dhe i hidhte duhan më nge. Plaka mernte zjarr e ndizej më tepër.

— S'ta solla me vete, mor ditëzi, që më rri si kërcu! Këtu në shtëpinë tënde e mbajta nëntë muaj, — shfrynte ajo.

— Ç'të bëj unë, moj? — mblidhte supet ai.

Një ditë Sanijes i zuri veshi në një komshie se në Korçë bënin karta që të mbaronin punë shpejt dhe e mblidhje mendjen. As një sekondë nuk qëndroi aty, po shkoi revan në shtëpi dhe iu zbraz plakut.

— Duhet të bëjë shumë, — tha Xha Mersini. — Presim dhe një javë, pastaj shohim e bëjmë.

— Sa Refija, a bën? — ishte hedhur plaka. — Sikur rrobat e trupit të shesësh e mos bëj pazar!

Këto kujtoi plakun, dhe dora padashur i shkau në portofol. Sa do të bënte, vërtet? A do t'i mbeteshin për grurë,

që Sanija të tërhollte një byrek, se u kishte mbirë misri në bark.

Ngriti lart supin e djathtë, shtyu hejbet më tej dhe trokiti shkopin e thantë në kalldrëmin e rrugës që çonte në postë-telegraf. Ngjiti shkallët e gurta të një ndërtese të vjetër dhe hyri në korridorin e gjatë. Dërrasat e vjetra të dyshemesë kërcitën nën opinga dhe nxorën ca tinguj gërvishës. Trokiti në derën e parë. Askush nuk u përgjigj. Mbajti vesh. Nga dhoma karshi sportelit dilnin ca zëra dhe tinguj që ngjanin me goditje të lehta të një çekani gome mbi metal: ta-ta-ti-ti... Trokiti. Përsëri asgjë.

— Çudi, çudi! — tkurri buzët e tundi kokën. — Porta hapur, zyrat, të kyçura, ziejnë si poçe me fasule. Ku drejtin erdha sot!...

Shtyu derën. Një sillë e ngrohtë iu përplas në fytyrë. Në një tavolinë të madhe prej dërrasash arre pranë dritares, ku ishin hedhur kuturu dosje të trasha, ishte një aparat morsi. Mbi të ishte ulur centralisti. Një xhandar i shkurtër me zverk të trashë, me mustaqe të përdredhura te këndi i buzëve dhe syze të rëna mbi samarin e hundës, ishte mbështetur te parvazi i dritares. Nuk ia hiqte sytë letrës që mbante në duar dhe e shtrëngonte fort, si të ishte një zog i trembur dhe druhej. Mos i fluturonte nga duart. I qeshi buza nën mustaqe dhe psherëtiu i kënaqur. Siç duket, gjeti atë që kërkonte, se i ra me bërryl centralistit, që çukiste me gisht në tavolinë.

— Hë!

— Fillo, — tha xhandari. — «Min-min-istrisë Punëve të Brendshme.

Tjetri goditi në tasto, nga dolën tingujt: ti-ti-ta-ta...

«Kjo qenka ajo e uruara që bënte ashtu!» — vuri buzën në gaz xha Mersini.

— Siç ju kemi njoftuar edhe më parë për ankimet

e punëtorëve, sot në datën 21 shkurt 1936 në qy-qy-tetin e Ko-korçës një de-demo...

— Demonstratë, do të thuash? — ngriti kokën centralisti...

— E, e, ashtu është, — buzëqeshi xhandari i lehtësuar dhe vazhdoi: — «e madhe nga punëtorët, studentët, e pap-parë ndonjëherë».

Xha Mersini ndenji te dera. E humbi mendjen pas belbëzimeve të xhandarit dhe nuk u kujtua ta shtynte pas. Një erë e ftohtë i rrëshqiti pas zverkut. Ata që ishin te dritarja u drodhën, si t'u kalonte një send i ftohtë në trup, po meqë i kishte rrëmbyer puna, nuk e ngritën kokën. Xhandari s'kishte kohë të fshinte as djersën që i sumbullonte në fytyrën e dhjamosur, nga frika se mos ngatërronte rreshtat. Centralisti jepte në tasto ato që i thoshin dhe shihte vëngër poshtë qyngjit të sobës portretin e merakosur të lartmadhërisë, varur në mur, dhe hera-herës murmuriste:

— Të hapën punë, o lartmadhëri, të hapën punë...

Nuk ishte e zorshme të shquaje shqetësimin që notonte në sytë e të dyve. Ajo shkresë u rëndonte si vare në shpatulla. Donin ta hiqnin qafe një orë e më parë dhe të merrnin frymë të qetë, ndonëse e dinin se me të tilla do të ngrysej dita dhe, siç kishte nisur, nuk dihej sa do të vazhdonte.

Era që frushullonte nga dera gjysmë e hapur ia thau djersën xhandarit dhe i futi mornica, po ai nuk e ndërpreu belbëzimin. Nga çasti në çast pritej të vinte Nihat beu, dhe ai duhet ta gjente telegramin të transmetuar. Po xhandarit nuk i shtyhej gjuha. Ai nuk mendonte gabimet, po nuk shquante dot gërmat, se i dukeshin të vogla, dhe syzet me xham të zakonshëm nuk e ndihmonin. Xha Mersini e vuri re. Edhe dhjetë çibukë të mbushje me

duhan dhe t'i tymosje më nge, prapë ai në të tijën do të vazhonte. «Duhet shtyrë kjo punë, se i zoti e nxjerr go-marin nga balta», — mendoi.

— Këtu bëhen ato kartat e shpejta? — pyeti

Asnjë përgjigje.

Iu afrua tavolinës.

— Kartat e shpejta këtu bëhen? — pyeti prapë.

— Ç'karta të shpejta, more? — thirri xhandari i ne-vrikosur dhe ngjeshi gishtin e madh aty ku kishte mbe-tur.

— Për Tiranë. Dua të pyes a më ka lindur çupa.

— Telegram kërkon? — tha centralisti dhe çoi lart krahët e lëvizi gishtërinjtë e mpirë.

— Telegram a kartë, si të duash ia vër emrin, mjafton të më bëjë punë.

— S'ta kemi qejfin sot, — tha xhandari i vrenjtur.

— Prefekti i ndaloi telegramet.

«Dhe këta s'qenkan në terezi, — mendoi plaku. — Mos kanë ngrënë narden!» — Si i ndaloi? S'e di ai që ne kemi halle?

— E di, s'e di, e di ai atë punë! — thirri xhandari i nevrkosur. — Bëhet merak ai për hallin tënd! Është qeveri ai, ore! Ka hall më të madh se ai që ka zënë qe-ve-rinë? Asaj i digjet mjekra, dhe zotrote kërkon të ndezësh duhanin!...

— S'më duhet mjekra e qeverisë mua, jo, — tha plaku si i zënë në faj. — Kam eshkën dhe masatin...

— Të prekërka gjuha si brisk, o plak. E di ti se ne kemi një më tepër? Kush llap për mbretin e qeverinë, i hedhim hekurat dhe e plasim brenda që të çuditet i madh e i vogël.

— Vetë ma zure mjekrën në gojë.

— Ta zura, po jo që të tallësh qeverinë ti, se s'të lë njeri! Ato i dimë ne.

Xhandari u koll pas kësaj ligjërate, si të pastronte fytyrën e të shkruftonte zërin, dhe uli sytë mbi letër, aty ku ishte mbërthyer gishti i madh.

— Vazhdo, — i tha centralistit — «Re-rebelët e nevrikosur janë derdhur rrugëve» .

Ca thirrje e britma si oshëtimë bënë të dridheshin xhamat.

Xhandari heshti.

— «Duan bukë, — vazhdoi pas pak. — Çfarë të bëjmë?»

— Të gjithë duan bukë? — pyeti xha Mersini.

— Jo të gjithë, jo. . . Brekëgrisurit, zorrëtharët qahen, po qeveria do t'u japë hakun.

— Le t'u japë bukën, dhe të rrinë rehat.

Xhandari vrenjti vetullat, po nuk foli. Papritur mori zjarr, si ta kishin fshikulluar me hithra. Hodhi letrën mbi tavolinë, shkopsiti xhaketën te fytyrën dhe vuri dorën te këllëfi i revolverit. Do ta kishte nxjerrë armën dhe do t'i qe sulur plakut, po Nihat beu u dha në derë, dhe ai mori qëndrim «gatitu!»

— E dhë? — pyeti Nihat beu duke dihatur.

— Edhe katër radhë.

— Po atë «çfarë të bëjmë?».

— Tani sapo e dhashë.

— Jo, jo, ta ndërrosh! Prefekti mori masa. Mos kujtojë lartmadhëria se ne çdo gjë e duam gati. . . Ose lëre, ma jep mua ta rregulloj. Ku ka mbetur?

— Këtu, — tregoi xhandari në letër dhe psherëtiu i lehtësuar.

Britma, këngë vinin nga rruga, si shpërthim dallgësh të shqetësuar. Nihat beu hodhi vështrimin përtej xhamit. Nxori sahatin e flarinjtë nga xhepi, psherëtiu dhe uli kokën në letër.

— «Rebelët e nevrík. . .»

— E dhamë një herë këtë, Nihat be, apo përsëritet?
Jemi te «Çfarë të bëjmë?».

— Ta hiqje këtë.

— E mori ferra uratën...

Në dhomë ra heshtja. Soba në krahun e djathtë të dhomës kërciste me bubullimë.

— Mirë, shto, — foli Nihat beu. — «Ne morëm masa...» E mbarove?

— Po.

— Po ky këtu? — Nihat beu tregoi me kokë xha Mersinin.

— Na është qepur për një telegram.

Ai bëri me shenjë, si t'u thoshte ta hiqnin qafe.

— Pa dale, zotëri, një kartë është, — tha me të lutur xha Mersini.

— Ik tani! Kemi tonat sot, — u ngrehos xhandari. E zuri për krahu, e nxori përtej pragut dhe i përplasi derën. Plaku rënkoj thellë, si të hiqte lëmshin e durimit që si kotkë i qe mbledhur në fyt. Kaloi nëpër duar tespijet, që instinktivisht dolën nga xhepi, po prapë ajo e keqe që i qe hedhur si lak në gurmaz, e shtrëngonte fort. Gjysmën e shekullit kishte kaluar xha Mersini, po nuk i kishte ndodhur ndonjëherë që t'i tregonin koburen, dhe ai ta linte të flinte në këllëf. Ishte përfolur me një turk njëherë, dhe ai i kishte nxjerrë koburen, po xha Mersini iu fut me sëpatë dhe e bëri fërtele. Një plumb i mbeti në shpatull, po dhembja i iku shpejt dhe e kujtonte vetëm kur lodhej shumë në arë e kur prishej koha. Po ky e kishte gjetur duarbosh. Nejse, kishte shkopin dhe mund t'ia mbante në çaçkë të kokës, pasi t'i thoshte: «Fute në bythë!». Po e mbajti veten. Çuditë çfarë nerva pati që ndenji kaq urtë. Nga halli e kishte, ku nuk të fut ai i shkretë kur të hedh kthetrat! Si t'ia bënte kartës, si t'i thoshte Sanijes? Pa mbaruar me të, as gruri nuk kishte rëndësi.

«U pa puna, — mendoi. — Prefektin e ka marrë malli për qeverinë».

Vuri shkopin në sjetull, çepkati një copë eshke mbi gur dhe trokiti me masát. Një shkëndijë e zjarrtë kërceu në masën e butë si sfungjer. Ajo zuri të tymoste me një duhmë të rëndë. Plaku e kapi me majat e gishtave si me mashë, e hodhi në mangallin e çibukut dhe e thithi fort. Sikur iu mpinë nervat tek mbushi bulçitë me tymin e hirtë dhe ndjeu t'i digjte në gurmaz. Prapë nisi ta hante meraku. «Nuk rrihet kështu, jo, — tha me vete. — Prefekti plëncin ka të madh, fjalët i ka të pakta».

Një shkëndijë e venitur shprese e bëri të shtynte derën, po kësaj here në të çarën e saj futi vetëm kokën.

— Të mbarojë nga mbrëmja prefekti me qeverinë?

Le t'i thoshin «po», dhe ai nuk do të ikte në fshat. Do ta kalonte natën në han a në ndonjë qoshe rruge, ku të mos e zinte era.

Po centralisti me Nihat beun nuk ia vunë veshin. Xhandari i hodhi ata sytë e mëdhenj dhe kapi këllëfin e revolverit, si t'i thoshte se durimi i kaloi kufijtë.

«S'qenka gjë», — tha me vete. Tërhoqi derën duke murmuritur me vete dhe zbriti shkallët e gurta të postë-telegrafit. Kaloi nga kuzhina dhe doli te kafeneja në krye të pazarit. Zëra, thirrje, britma, këngë i erdhën më shkoqur në vesh.

— Bukë! Bukë!

Para bashkisë ishte mbledhur një mizëri njerëzish. Te dera e saj ruanin xhandarë. Mbi kryet e turmës lëviznin ca kartona të gjërë me gërma. Në njërin prej tyre xha Mersini shqoi dy duar të shtrenguara.

«Këta duhet të jenë rebelët, ata që ia kanë prishur qejfin prefektit», — mendoi. Brenda xhamave të bashkisë dhe në ballkon nuk dukej njeri. Burra të parruar, pleq të thinjur, djem të hedhur, me kapele të rrasura thellë në

kokë, liceistë me pantallona e fuska, gra me mësalla, fytyrëvrenjtur, shtrëngonin grushtat, i tundnin në ajër dhe, si një shpërthim vullkani, nga gjokset e tyre vërshonin britmat:

— Bukë! Bukë!

Në detin e pafund të turmës që dallgëzonte mbi kall-drëm, si një pyll i dendur në një ditë stuhie, lëkundeshin grushtat. Nga gjokset e zbuluara leshtore të disave zinin fill këngët.

Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë...

Tingujt e këngës i shoqëronte dhe fërshëllima e erës së Moravës. Edhe ajo sikur bashkohej me korin e zërave e protestonte përpara bashkisë.

Tani e kuptoi xha Mersini përse zienin rrugicat e këpucarëve e të rrobaqepësve, përse uleshin qepenat me zhurmë. Kërkoi në dallgët e turmës kripaxhiun, djalnin me fytyrë vrarëlie, por nuk i pa. Nga rrugicat pranë, grupe-grupe, njerëzit hynin në vazhdën e turmës si përrrenj të vegjël në shtratin e një lumi të madh e të gjerë. Turma rritej e rritej. Si pa kuptuar, edhe ai ishte rrëmbyer nga vrundulli i saj.

— Duam bukë! Duam bukë!

Në fillim murmuriti dhe ai, pastaj ngriti zërin dhe zuri të thërriste më shkoqur. «Më iu lumtë «rebelëve!» — tha me vete dhe vuri buzën në gaz. Rrudha kënaqësie i vizuan ballin e mollëzat dhe bënë t'i ngriheshin lart mustaqet e thinjura.

— Liri të arrestuarve!

Përbri tij një burrë i fliste një tjetri se dhe ai kishte dorëzuar çelësat e dyqanit në Odën e Tregtisë. Një ditë më parë xhandarmëria kishte arrestuar më tepër se dhjetë vetë që kërkonin të drejtat e tyre.

— Duam djersën tonë!

Thirri me sa i hante zëri edhe xha Mersini. Iu kujtuan dynymët e tij. Vetëm misër i mbillte. Sa herë hidhte farë, me djersë e vadiste. Kur e fuste në hambarë, vetëm çereku i mbetej, se taksat dhe fajdetë ia hanin bereqetin si epidemi kolere. Asnjë vit nuk e kishte shtyrë dimrin pa zgjatur dorën. Servet beu i jepte me naze, megjithëse fajdenë e kërkonte të majme. Qehallarët ia dërgonte përherë kur vinte afati. Katër fëmijë kishte xha Mersini, po asnjë nuk iu bë krah si deshi ai. I kishte çupa, e ato, kur hidhnin shtat e bëheshin të zonjat për punë, shkonin te burri.

Te balli i turmës u sulën me vrap xhandarët dhe u rreshatuan me bajonetat ngrehur. Mbi kokat e njerëzve një diell i madh shkau në kurthin e dendur të reve. Ai pleksej e rrokullisej me to në një betejë të përgjakshme. Hera-herës ato e gllabëronin të tërin. Nga kreu i turmës trupi i një djaloshi u ngrit më lart se kokat e njerëzve dhe lëvizte duart në ajër në drejtim të xhandarëve.

— Na lini të kalojmë. Jeni vëllezërit tanë. Duam bukë për fëmijët tanë.

— Atje, atje! — thirri një xhandar dhe shtriu kra-hun nga mesi i turmës, ku kuqëlonte në valëvitje një flamur i kuq me zhgabën dykrerëshe. Xhandarë të tjerë e panë dhe u turrën të çanin gardhin e ngjeshur të turmës, po gjokset e njerëzve ua prenë hovin. Goditje me kondakë, drurë, grushta, shqelma, klithma. Bajonetat u ngritën drejt qiellit e qëlluan kuturu. Duart e rreshkura e tërë kallo të zanatçinjve i përplasën armët në gurët e shkallëve të ndërtesës së re, që ishte menduar nga qeveria të bëhej bashki.

Xha Mersini fërkoj sytë dhe hodhi vështrimin nga ishte ngritur djali.

— Të shkojmë përpara! Askush nuk na ndal dot! — thirri ai.

Kjo thirrje, si një magnet, e tërhoqi turmën dhe e shtyu disa hapa më tej.

— Qerratai! — tundi kokën xha Mersini. — I bëri për vete të gjithë.

Iu bë sikur pa djalin e kripës. Deshi t'i shkonte pranë, po një burrë tridhjetepesëvjeçar ishte rrokur me një xhandar dhe nuk lëvizte dot. Xhandari ishte i shëndoshë dhe arriti t'i hidhte duart në fyt. Burri u skuq në fytyrë dhe kapelja e arnuar i ra përtokë.

— Bjerini! — thirri një liceist dhe i kërceu xhandarit në shpinë. — Po e mbyt!

Grushtat u derdhën si breshëri në kurrizin e xhandarit. Xha Mersinit iu bë se ishte ai i post-telegrafit. Ndër mend i erdhi turku. Sytë i vanë te këllëfi i revolverit. «Paska mbaruar punë, hë!.. — tha me vete. — Fute në bythë!» — shau dhe lëshoi hejbet.

Ngriti shkopin e thantë dhe mbajti fuqinë e krahut në kokën e xhandarit. Ajo krisi fort, si një bostan i papjekur që çahet. Duart buçkane që kishin lakuar fytin u hoqën ngadalë. Ata që ishin pranë bënë më tej, dhe xhandari kafshoi dhé.

— Faleminderit, xhaxha! — foli burri dhe u mundua të buzëqeshte, por dhembja në fyt nuk e la, se shtrëngoi dhëmbët. — Mirë ia bëre. Sot u kërkojmë bukën, nesër...

— E deshi, or bir, e deshi. E kërkoi si breshka gozhdën.

Burri ngriti kokën lart, fërkoj qafën e gjatë dhe shtyu këmbët më tej, i dyndur nga një valë e re e turmës. Xha Mersini rrëmbeu hejbet dhe u mbështet në vitrinat e një ëmbëltoreje. Balli dhe mustaqet i qenë bërë ujë nga pesha e hejbeve dhe nga frymëmarrja e afërt e njerëzve. Kaloi shkopin në dorën tjetër dhe nxori shaminë. Një letër e zhubrosur ra përdhe. Ishte ajo që shkroi hoxha për të bijën. U ul ta merрте, po ndërroi mendje.

— Vate ajo, që kur s'e pranoi mustaqemu. . .

Dhe shkoi pas tyre. Nga rruga e Mitropolisë zbriste një grup tjetër dhe u përzie me turmën. Dielli kishte mbaruar betejën me nofullat e çapëluara të reve, që i ngjnin një hipopotami të mundur, dhe kishte dalë në qiell të kaltër e të qëruar. Xha Mersini e pa mbi çati, pastaj nuk pati kohë të shihte përpjetë. Prapëseprapë rrezet e vakëta të diellit nuk i ndaheshin. Dukej sikur dielli ishte copëzuar në mijëra pjesë dhe reflektonte në ninëzat e njerëzve.

Xhandarë të tjerë rendnin nga të gjitha rrugët, po turma nuk e ndalte hapin.

— Duam bukë! Djersën tonë!

— Duam bukë! Djersën tonë! — thirri xha Mersini.

E harroi okën e kripës, dorën e grurit dhe kartën e shpejtë. I dukej sikur kishte gjetur njerëzit e dashur dhe kishte marrë një këngë zemre në një dolli të posafilluar. Kjo ishte më e fortë se porositë që i kishte dhënë plaka në fshat dhe e bënte t'i trokiste zemra më shpejt dhe këmbët e plakura t'i luante si djalë i ri.

Ishte një pasdite e ftohtë shkurti, po njerëzit nuk e ndienin këtë. Sikur i kishte gllabëruar kjo ecje e nisur dhe nuk e ndalnin vrapin.

Nga grykat e Moravës frynin erëra të ftohta.

P Ë R M B A J T J A

Mes ditëve	3
A nuk do ta fitojmë ne luftën?	14
Zjarre nate	24
Thyerja e qivurit	33
Vullnetarët	49
Babai	63
Gjak	70
Frynin erërat e Moravës	77